



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 122

Tiranë – E mërkurë, 4 shtator 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 28.8.2019	Për miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019–2020..... 8975
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 517, datë 3.9.2019	Për delegimin e kompetencave..... 8999
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7714, datë 2.9.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Isuf Balta’, Tiranë”..... 8999
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5172/4, datë 2.9.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 19, datë 16.1.2019, ‘Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, qendra e qytetit Roskovec”” 9005



VENDIM
Nr. 580, datë 28.8.2019

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
KONSOLIDUAR KOMBËTAR TË
VEPRIMIT PËR BURIMET E
RINOVUESHME TË ENERGJISË,
2019–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 6, të nenit 5, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë, 2019–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 179, datë 28.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2018–2020”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit
për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
në Shqipëri 2019–2020**

Tabela e përmbajtjes

1. Progresi dhe nevoja për Konsolidimin e PKVBRE 2018–2020

1.1 Hyrje

1.2 Trajektorja detyruese e përqindjes së BRE-së në ligjin 7/2017

1.3 Ligjshmëria për konsolidimin e PKVBRE 2018–2020

1.3.1 Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë

1.3.2 Detyrimi për miratimin dhe monitorimin e PKVBRE

2. Nevoja për të konsoliduar PKVBRE 2018–2020

2.1 Zbatimi i Politikave të BRE-së për Konsolidimin e PKVBRE 2018–2020.

2.2 Politika e tarifave të rregulluara

2.3 Progresi i projekteve të BRE-së gjatë 2018

2.4 Dhjetor 2018, gjendja sasiore e BRE-së 2018–2020

2.5 Dhjetor 2018 - statusi i Objektivit Kombëtar 2020

3. Kostot konkurruese për të prodhuar energjinë elektrike nga BRE-të

3.1 Hidrocentralet e vogla (HECV)

3.1.1 Procesi i skanimit, janar 2019

3.1.2 Mbështetja financiare për HEC-et e vegjël deri në 15 MW

3.1.3 Dhjetor 2018 - Zhvillimi i HEC-eve të vogla (HECV)

3.2 Foto Voltaiket (PV)

3.2.1 Fotovoltaiket me mbështetje tarifore

3.2.1 Orët në pikë që mbulojnë analizën përfaqësuese të zonave më fisibel për PV mbi 2 MWp.

3.3 Energjia e erës (Eolike)

3.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga pjesa e degradueshme e mbetjeve të ngurta urbane, industriale dhe rurale (MNU)

3.4.1 Tarifat e miratuara të MNU

3.5 Energjia nga Biomasa për Ngrohje (BER-N&F)

3.5.1 Biomasa drusore

3.5.2 Biomasa nga bujqësia, pularia dhe mbetjet

3.6 Biokarburantet (BER-T)

3.7 Përmbledhje e politikave dhe masave për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme BRE. Politikat e diversifikimit të BRE-ve në Shqipëri?

3.7.1 Objektivat Strategjike të Politikave të rekomanduara për BRE

3.7.2 NDC dhe veprimet për ndryshimet klimatike

4. Konkluzione dhe rekomandime

4.1 Sasitë e BRE-së të domosdoshme për të realizuar Objektivin Kombëtar 38%

4.1.1 Energjia e rinovueshme për sektorin e Transportit (BRE-T):

4.1.2 Energjia e rinovueshme për Ngrohjen dhe Ftohjen (BRE-N&F):

4.1.3 Energjia e rinovueshme për prodhimin e Energjisë Elektrike (BRE-E):

4.2 Sasitë e BRE-së në Planin e Konsoliduar.

4.3 Investimet në BRE dhe llogaritja e tarifave të rregulluara

4.3.1 Llogaritja kumulative e financimeve për 2019–2020

4.3.2 Parametrat tekniko-ekonomike të teknologjive që përcaktohen në metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë nga PV, Eolike dhe HECV për BRE-E.

Lista e akronimeve

AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
BRE-E	Burimet e Rinovueshme të Energjisë për prodhimin e Energjisë Elektrike
BRE-N&F	Burimet e Rinovueshme të Energjisë për Ngrohjen dhe Ftohjen
BRE-T	Burimet e Rinovueshme të Energjisë për Transport
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
EUROSTAT	Statistikat Evropiane
HEC	Hidrocentral
HECV	Hidrocentral i vogël
INSTAT	Instituti i Statistikave
KFBE	Konsumi Final Bruto i Energjisë
ktoe	Kilo ton ekuivalent naftë
KM	Këshilli i Ministrave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
OST	Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit
OER	Operatori i Energjisë së Rinovueshme
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë
PKKVBRE	Plani Kombëtar i Konsoliduar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të
SKE2030	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2030
TFE	Totali i Furnizimit me Energji
KFBE	Konsumi Final Bruto i Energjisë
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis



1. Progresi dhe nevoja për Konsolidimin e PKVBRE 2018–2020

1.1 Hyrje

Politikat e Energjisë së rinovueshme pas miratimit të ligjit të shfuqizuar 138/2013 dhe ligjit aktual 7/2017, deri sot, përbëhen nga dy Planet Kombëtare të Veprimit për BRE-të, (2015–2020) dhe (2018–2020). Ligji parashikon rishikimin e tyre në çdo 2 vjet. Plani i parë, 2015–2020 u rishikua sipas parashikimeve ligjore dhe aktualisht MIE, si përgjegjëse e drejtpërdrejtë për zbatimin, ka në fuqi PKVBRE 2018–2020, i cili përveç masave në kuadrin ligjor, përcakton **metodologjitë** e vendosjes së çmimit të blerjes së energjisë nëpërmjet “**Skemave të Mbështetjes Financiare**” si angazhim i drejtpërdrejtë i Qeverisë për arritjen e Objektivit Kombëtar. Tabela 1 jep sasi të planifikuara dhe progresin deri në fund të 2018-s në përputhje me vendimet e marra në Qeverinë Shqiptare për BRE-në.

Planet janë miratuar përkatësisht me VKM-në nr. 27, datë 20.1.2016 (shfuqizuar) dhe VKM-në nr. 179, datë 28.3.2018, plan i cili është aktualisht në fuqi. Sipas ligjit, Planet përfshijnë masa për arritjen e Objektivit Kombëtar prej **38%** të pjesës së Energjisë së Rinovueshme në raport me Konsumin Final Bruto të Energjisë (KFBE) deri në vitin 2020.

Planet Kombëtare të Veprimit deri në 2020-n, përcaktojnë udhërrëfyesin për arritjen e Objektivit Kombëtar, 38%, si përqindja e BRE-ve në tre¹ sektorët baze, në raport me KFBE deri në 2020-n:

1. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e energjisë **elektrike** (BRE-E),
2. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e **transportit** (BRE-T) dhe,
3. Burimet e Energjisë të Rinovueshme në sektorin e **ngrohjes/ftohjes** (BRE-N&F).

Gjithashtu Strategjia Kombëtare e Energjisë (SKE), miratuar me VKM-në nr. 480, dt. 31.7.2018, është shprehur për rritjen e kapaciteteve të BRE-ve në **42% për** periudhën 2020–2030. Një Plan Kombëtar i Integruar për Energjinë dhe Klimën është duke u përgatitur nga Ekspertë të GiZ, EnC dhe BE, i cili në thelb do të përcaktojë masat për arritjen e objektivit të BRE-së dhe GHG (Green House Gases) në vitin 2030.

1.2 Trajektorja detyruese e përqindjes së BRE-së në ligjin 7/2017

Plani i Konsoliduar Kombëtar Veprimet për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (2018–2020), përcakton udhërrëfyesin e arritjes së objektivit kombëtar për përqindjen e energjisë nga burimet e rinovueshme që duhet të konsumohet deri në vitin 2020 për tre drejtime të BRE-së:

- a) Në sektorin e energjisë elektrike (BRE-E),
- b) Në sektorin e transportit (BRE-T), dhe
- c) Në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes (BRE-N&F).

Të tre sektorët e mësipërm kanë peshën e tyre përqindjen e llogaritur të BRE-ve, por Trajektorja udhëzuese në shtojcën 1, të ligjit 7/2017 tregon përqindjen detyruese të përgjithshme si shumatore të tyre:

Pjesa e energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në vitin 2009	Mesatarja për 2011-2012	Mesatarja për 2013-2014	Mesatarja për 2015-2016	Mesatarja për 2017-2018	Objektivi për energjinë e rinovueshme në vitin 2020
31,2 %	32,6 %	33,2 %	34,3 %	35,6 %	38 %

Siç duket edhe nga analiza mes vitit 2018 dhe 2020 është një shtesë prej 2.4% e cila në bilancin e parashikuar për 2020 (2120 ktoe) është të paktën 50.88 ktoe. **Pyetja është se sa e qëndrueshme është kjo përqindje?**

Për të gjetur se sa e qëndrueshme është arritja e këtij objektivi të parashikuar në ligj, është e domosdoshme të zhvillojmë **analizën sasiore** dhe **pritshtëmërinë** se:

në vitin 2020 Shqipëria do të prodhojë dhe konsumojë 38% BRE, në raport me KFBE të parashikuar për tu konsumuar në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe naftën, gazin, qymyrin, energjinë elektrike të importuar që supozohet së është me prejardhje fosile (jo të rinovueshme).

1.3 Ligjshmëria për konsolidimin e PKVBRE 2018–2020

1.3.1 Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë

Agjencia përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë është parashikuar të ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin 7/2017, neni 7 “Detyrat e agjencisë përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë”.

¹ Në përputhje me të dhënat statistikore sipas rekomandimeve të Direktivës 2009/28/BE dhe ligjit 7/2017.



Si Agjenci përgjegjëse për BRE-të dhe si institucion në varësi të ministrit, **duhet të kryente** këto detyra:

- krijimin, regjistrimin dhe përditësimin e regjistrit të prodhuesve nga HECV;
- regjistrimin e bilancit të energjisë të të gjithë prodhuesve me përparësi;
- hartimin dhe dorëzimin në ministri, të draft-PKVBRE, në afatet e përcaktuara nga ligji;
- monitorimin e zbatimit të PKVBRE, të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
- hartimin dhe dorëzimin në Ministri dhe ERE, brenda datës 1 qershor të çdo viti, të vlerësimit të pjesës së energjisë së prodhuar nga BRE, krahasuar me KFBE për vitin paraardhës;
- përgatitjen e informacionit për masat që merr Ministria, përfitimeve, kostove të zhvillimit dhe përdorimit të BRE-ve, si dhe rreth masave mbështetëse, të cilat duhet të jenë transparente për të gjitha palët e interesuara.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, cakton ose krijon institucionin, i cili do të ushtrojë detyrat e agjencisë përgjegjëse për Burimet e Rinovueshme të Energjisë. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke e krijuar këtë institucion dhe, deri në përfundim të procesit të krijimit të Agjencisë, ka detyrimin të japë të dhëna të arsyeshme për të deklaruar Statusin e BRE-ve brenda një kohe të arsyeshme.**

1.3.2 Detyrimi për miratimin dhe monitorimin e PKVBRE

Në ligjin 7/2017, neni 5 “Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë” janë vendosur gjithashtu edhe këto detyrime:

- PKVBRE-ja **përcakton masat për arritjen e objektivave kombëtarë**, si pjesë e konsumit përfundimtar bruto në vitin 2020, sipas përcaktimit në shtojcën nr. 1 të ligjit (pika 2).
- PKVBRE-ja **miratohet nga Këshilli i Ministrave**, me propozimin e ministrit dhe i njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (pika 3).

- Zbatimi i PKVBRE-së monitorohet nga **Agjencia përgjegjëse për BRE-të**, e cila i paraqet ministrit raportin vjetor të monitorimit, brenda datës 30 qershor të çdo viti (pika 4).

- Ministria i paraqet Këshillit të Ministrave një **raport për zbatimin e PKVBRE-së dhe përmbushjen e objektivave kombëtarë** për

energjinë nga burime të rinovueshme (pika 5).

- Nëse raporti i monitorimit, paraqet se pjesa e energjisë nga BRE-të është më e vogël se një pikë përqindjeje sesa vlera e trajektores udhëzuese për periudhën e dy viteve të ardhshme, **ministria i propozon Këshillit të Ministrave ndryshimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë**, duke përcaktuar masat e duhura dhe të përshtatshme për të arritur trajektoren udhëzuese (pika 6).

Si konkluzion:

Rishikimi i PKVBRE 2018–2020, është i ligjshëm dhe lejon mundësinë për të përcaktuar masat e duhura dhe të përshtatshme për të arritur trajektoren udhëzuese.

2. Nevoja për të konsoliduar PKVBRE 2018–2020

Konsolidimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKVBRE) 2018–2020, nuk është një detyrim ligjor që buron nga neni 5, i ligjit nr. 7, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e burimeve të Rinovueshme të Energjisë”, dhe as detyrim i Shqipërisë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Plani i Konsoliduar Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë (PKVBRE) lidhet me **vendimmarrjen e ndërmjetme** dhe angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të arritur Objektivin Kombëtar të Prodhimit në territorin e Shqipërisë të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE) në masën 38% në raport me Konsumin Final Bruto të energjisë (KFBE) deri në vitin 2020.

PKVBRE i miratuar me VKM-në nr. 179, datë 28.3.2018, vendosi objektiva ambicioze për përmbushjen e Objektivit Kombëtar deri në 2020: 38% e energjisë që prodhohet në vendin tonë, krahasuar me KFBE, do të jetë me prejardhje të rinovueshme, jofosile. Për arritjen e Objektivit janë miratuar leje me tarifa të rregulluara për këto burime dhe janë miratuar metodologji për çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga BRE-të.

2.1 Zbatimi i Politikave të BRE-së për Konsolidimin e PKVBRE 2018–2020

Ligji “Për nxitjen e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë” u miratua në 2 shkurt 2017. Ky ligj është harmonizuar me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe reflekton në mënyrë të plotë mundësinë e hyrjes në tregun e



liberalizuar të energjisë elektrike të gjeneruesve, nga burime të rinovueshme.

Ligji konservon kontratat koncesionare për hidrocentralet e vogla të miratuara më parë deri në 15 MW. Gjithashtu si një nevojë e diversifikimit, merr në konsideratë nxitjen e burimeve të tjera me prejardhje të rinovueshme si Eoliket apo PV. Në çdo rast, ligji krijon mundësinë e mbështetjes financiare me tarifa të rregulluara (*feed-in-tarif*) dhe sipas Kontratës për Diferencë (*feed-in-premium*), qoftë për prodhuesit ekzistues dhe të rinj me përparësi, ashtu edhe prodhuesit e rinj pas fundit të vitit 2017, kur filluan të funksionojnë kontratat që nuk ishin objekt koncesioni sipas një procedure të miratuar me VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, i ndryshuar.

Gjithsesi, sektori i energjisë elektrike i rregulluar me ligjin nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, plotësisht i përafuar me direktivën 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm në energjinë elektrike, afektohet nga prodhimi vendas i energjisë elektrike nga BRE-të sepse praktikisht, energjia elektrike sot në Shqipëri prodhohet 100% me energji të rinovueshme, kryesisht hidro. Kështu, VKM-ja nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, në kushtet e Shqipërisë, ishte një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike nga Burime të Rinovueshme në Shqipëri, si plotësisht konkurrues dhe në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Si nevojë e hapjes graduale të tregut, ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” u ndryshua me ligjin nr. 7/2018, datë 15.2.2018, për të lejuar ngritjen e bursës së energjisë elektrike (APEX). Bursa do të organizohet dhe do të funksionojë si një platformë e tregut elektronik për energjinë elektrike duke plotësuar një nga angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Kjo masë, përveçse do të liberalizojë më tej tregun e energjisë në Shqipëri, do të lejojë së pari Burimet e Rinovueshme të energjisë dhe mbështetjen financiare të organizohet nëpërmjet OER (Operatorit të Energjive të Rinovueshme, neni 11, ligji nr. 7/2017) dhe të krijojë mundësinë për konkurrueshmëri të BRE-ve në tregun e liberalizuar.

Sipas ligjit, OER duhet të mbajë të dhëna të hollësishme për të gjitha masat mbështetëse. Këto

të dhëna duhet të mbahen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për diferencë dhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vitesh, duke përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar se kushtet e kontratës për diferencë janë përmbushur. Pas konsolidimit të akteve për Operatorin e Energjisë së Rinovueshme, ky i fundit do të publikojë çdo vit detajet e llogaritjeve e të shpërblimeve, sipas kontratave për diferencë. OER kryen një vlerësim të fazës së parë të procesit konkurrues, përfshirë përqindjen e realizuar të projekteve të energjive të rinovueshme të deklaruar fitues në procesin konkurrues, pas marrjes së certifikatës së pranimit të veprës.

Në këtë kuadër, për t’iu paraprirë reformave në sektorin e energjisë elektrike dhe për të realizuar objektivin 38% të BRE në KFBE, në PKKVBRE të rishikuar të periudhës së mbetur 2018–2020 rekomandohen:

i) masa efektive për **diversifikimin e burimeve të rinovueshme** në Shqipëri dhe vlerësimin e masave për potencialin e burimeve miqësore me mjedisin, me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar;

ii) analizë tekniko-ekonomike më të gjerë lidhur me interesat e të gjithë operatorëve të tregut të Burimeve të Rinovueshme në aplikimin e “skemave mbështetëse” për promovimin e BRE-ve pa dallim dhe me bazë transparente;

iii) vlerësimin dhe më pas analizën e lehtësisë dhe barrierave të procedurave administrative kombëtare për promovimin e burimeve të rinovueshme. Bazuar në parimin e “kush të vijë më parë - i pari shërbehet”, në çdo rast kur Qeveria të shprehet për kapacitete diversifikuese të kërkuara sipas këtij Plani në gjenerimin e energjisë elektrike;

iv) përforcimin e legjislacionit për biokarburantet në sektorin e Transportit në drejtim të kriterëve të qëndrueshmërisë, informimin/raportimin, si dhe vendosja e masave për nxitjen e tregtimit të tyre te konsumatori fundor.

PKKVBRE 2018–2020 është në koherencë me Direktivën, dhe rekomandon që procedurat për lejet e ndërtimit të impianteve me burime të rinovueshme të lehtësohen ndjeshëm. Plani rekomandon dhënien e lejeve për ndërtimin e impianteve të BRE-ve në përputhje me strategjinë e Diversifikimit të Burimeve të Rinovueshme duke lejuar:

1. Respektimin e koncesioneve të HECV-ve të dhëna sipas një procesi të konkurrimit të ofertave.



2. Dhënia e autorizimeve për gjenerimin e energjisë elektrike me burime të rinovueshme të ndryshme nga Hidro, si autorizimet për PV deri në 2 MW dhe Eolike deri në 3 MW.

3. Dhënia e autorizimeve për gjenerimin e energjisë elektrike sipas një procedure transparente që mund të përfshijë edhe organizimin e ankandeve mbi 2MW për parqet Diellore në toka të kripura dhe impianteve mbi 3 MW të parqeve Eolike.

4. Dhenia e autorizimeve për sistemet diellore PV notues.

2.2 Politika e tarifave të rregulluara

Sa më sipër, Politika Energjetike për BRE-të, është ushtruar nga MIE nëpërmjet PKVBRE 2018–2020 të parashikuara në ligj (138/2013 – i shfuqizuar dhe 7/2017 – aktual). Me qëllim nxitjen e investimeve në energjinë e Rinovueshme, dhe sidomos, për të aritur Objektivin Kombëtar të Burimeve të Rinovueshme (38% deri në 2020) janë propozuar kapacitete gjeneruese si HECV, PV, Eolike, MNU, Biomassë dhe Biokarburante.

Përveç të tjerash, PKVBRE 2018–2020 ka propozuar masa dhe ka vendosur Kapacitete Gjeneruese të energjisë elektrike të cilat përfitojnë masa mbështetëse sipas parashikimeve në Plan. Në ligjin 7/2017 është reflektuar **vendosja e dy lloj mbështetjeje financiare për BRE-E:**

1. Vendosja e tarifës FiT “*Feed-in-Tariff*”, është mbështetje ligjore financiare për çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme me kapacitete gjeneruese të limituara deri në 2 MW dhe 3 MW për impiantet Eolike. Këto vepra gjeneruese miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë sipas procedurave që parashikon VKM-ja nr. 822/2015, e ndryshuar me VKM-në nr. 718/2016. Në thelb, një metodologji e propozuar nga MIE dhe e miratuar me VKM, i propozon ERE-s miratimin e çmimit fiks që prodhuesi do të shesë tek OSHEE-ja për 15 vjet.

2. Vendosja e tarifës FiP, “*Feed-in-Premium*”, është mbështetje ligjore financiare në çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme me kapacitete gjeneruese mbi 2 MW dhe 3 MW për impiantet Eolike.

3. Kapacitete gjeneruese të dhëna sipas një procedure transparente dhe konkurruese me anë të ankandit. Kjo procedurë është dhënë sipas vendimit nr. 349, datë 12.6.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e

rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, ka të bëjë me kërkesën e paraqitur nga MIE për kapacitete ku, pika e lidhjes me rrjetin, pronësia e tokës dhe PPA (*Power Purchase Agreement*) ose një kontratë blerjeje e energjisë për 15 vite, me çmim fiks që del nga ankandi, janë pikat kyçe të kontratës së ardhshme të parablerjes. Në këtë rast, kjo kontratë mund të jetë edhe një Kontratë për Diferencë (CfD- *Contact for Difference*) që bëhet e aplikueshme me krijimin e një tregu funksional të ditës në avancë, të aksesueshëm për prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit e të erës dhe të bërjes efektive të bursës shqiptare të energjisë.

4.

Sa më sipër **mbështetja financiare jepet vetëm për të arritur** e 38%-shin në deri në 2020-ën duke propozuar **kapacitete të veprave të prodhimit të energjisë nga Burime të Rinovueshme të Energjisë (BRE), të miratuara nga Qeveria**, si angazhim i drejtpërdrejtë për të subvencionuar energjinë e pastër, përkundëjt importeve, të cilat llogariten si energji me prejardhje fosile.

Në kuptimin ligjor, PKVBRE i miratuar me VKM, është shprehja e interesit të Qeverisë për kapacitete të kërkuara të prodhimit të energjisë, Plan i cili së bashku me Metodologjitë për Tarifatat (FiP-CfD dhe FiT) janë **referencë për të limituar** kapacitetet e parashikuara në Planin Kombëtar.

Në rastin e HEC-eve të Vogla dhe të Mesme deri në 15 MW është tejkaluar ndjeshëm kjo pritshmëri². Ndërkohë, në teknologjinë e PV nuk janë plotësuar me kapacitete dhe ato Eolike akoma janë në fazën fillestare.

2.3 Progresi i projekteve të BRE-ve gjatë 2018

Nga një vështrim paraprak i progresit që kanë pësuar BRE-të gjatë 2018 duket qartë se, pas aprovimit të ligjit 7/2017 u krijua baza ligjore për mbështetjen financiare fikse të **HEC-ve të Vegjël** (HECV) deri në 2 MW. Kështu, përveç 171 kontratave koncesionare për 2,105 MW, në MIE gjatë 2017-2018, janë nënshkruar edhe 71 kontrata për 78 HECV, me fuqi totale 98 MW. Kjo solli një stok të konsiderueshëm të HECV-ve dhe në total

² Mbështetur në shifrat e deritanishme të kontraktuara për HECV deri në 15MW, janë dhënë në total **2,203MW**.



janë dhënë 2,203 MW kapacitete gjeneruese të kontraktuara. Kështu, numri i HECV është 527 me një numër total të 251 kontratave koncesionare ose jo.

Gjithashtu, gjatë fundit të vitit 2017 deri në dhjetor 2018 pati shumë aplikime për skemat promovuese deri në 2 MW, për impiantet Foto-Voltaike (PV) dhe 3 MW për impiantet Eolike. Kërkesat u mbështetën në kapacitetet e propozuara në PKVBRE 2018–2020. Me qëllim përcaktimin e një çmimi promovues për blerjen e energjisë, MIE propozoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme (dielli dhe era)” e cila u miratua me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017. Tre muaj më vonë, në 27.7.2017, ERE miratoi këtë metodologji e cila përcaktoi tarifën promovuese 100 €/ MWh për impiantet PV dhe 76 €/MWh për impiantet Eolike deri në 3 MW të instaluar. Deri në 31 dhjetor 2018, në MIE janë paraqitur të paktën 75 aplikime për impiante PV deri në 2 MW, dhe 11 prej tyre janë pajisur me “Miratimin përfundimtar” dhe kanë nënshkruar kontratën me MEI/MIE për ndërtimin e impianteve me energji diellore për 100 EUR/ MWh tarife *Feed-In-Tariff* (FIT).

Po kështu ankandi në Akerni Vlorë, rezultoi i suksesshëm për 50 MW me mbështetje të dhënë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 349, datë 12.6.2018. Në PKVBRE 2018–2020 janë parashikuar 120 MW impiante diellore PV, nga të cilat 50+24=74 MW janë dhënë, dhe mbeten edhe 48 MW. Për shkak të boshllëkut ligjor, bie në sy se rreth 18 MW instalime PV janë dhënë me çmimet 100 EUR/MWh brenda vitit 2017 dhe thuajse në të njëjtën zonë (Sheq Marinëz, Topojë Fier).

ERE, pasi miratoi çmimet e blerjes së energjisë nga impiantet PV për vitin 2017, duhet të rishikonte këto çmime për vitin 2018 dhe 2019, bazuar në metodologjinë e mësipërme sipas parimeve të njohura të LCOE (*Levelized Cost Of Energy*) për skemat promovuese, si çmime të mbështetura në trendin rënës të kostove të këtyre impianteve në tregun ndërkombëtar dhe për të kthyer investimin në kohë të arsyeshme. Të paktën 3 subjekte presin të miratohet ky çmim.

Angazhimi i Qeverisë për të zhvilluar më tej BRE-ja shprehet edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 të miratuar me VKM-në nr. 480, datë 31.7.2018. Objektivi deri në 2030 do të jetë të paktën 45% të KFBE të parashikuar për këtë vit.

Gjithashtu, Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021 i miratuar me VKM-në nr. 201, datë 10.4.2019, përfshin masa afatshkurtra dhe afatmesme për të arritur prodhimin e BRE-së deri në vitin 2021, me synimin që Shqipëria të ketë përafërsisht plotësisht legjislacionin në përputhje me *acquis* për energjinë të BE-së, ku të gjithë sektorët që ndikohen nga energjia, të përmbushin standardet e përcaktuara në kapitujt e *acquis*.

2.4 Dhjetor 2018, gjendja sasiore e BRE-ve 2018–2020

Plani Kombëtar 2018–2020, i cili ka shërbyer si një dokument Politikash për zhvillimin e BRE-ve për prodhimin e energjisë elektrike është realizuar në tërësi në masën 78.6%, duke përfshirë këtu, pritshmërinë që objektet gjeneruese të energjisë elektrike që janë me status “gjatë ndërtimit” të jenë përfunduar brenda vitit 2020.

Nga të dhënat e deritanishme realizimi i PKVBRE 2018–2020 i miratuar me VKM nr. 179, datë 28.3.2018 është:

Tabela 1 – Kapacitetet e planifikuara shtesë që duhet të arrihen deri në 2020-en dhe fakti – 31/12/2018

Teknologjitë shtesë të BRE-ve 2018–2020		Sasia ktoc		Gjenerimi GWh/vit		Instalimi MW	
		Plan-Fakt		Plan-Fakt		Plan-Fakt	
BRE-E elektricitet	HECV deri në 15 MW	212.8	126	1,600	947	600	507
	Eolike (Wind)	28.0	0	210	147	70	41
	Fotovoltaike (PV)	15.0	0	174	111	120	74
	MNU (Mbetjet e Ngurta Urbane)	5.0	4	60	48	8	15+6
	HEC-e të Mëdhenj 4.2TWh ³	361		4,200		1,448	
	Total 1 përfshirë në PKVBRE	172	130	2,044	1,253	798 MW	628MW
DIFERENCA 2018			10 ktoc		791 GWh		170MW
BRE-N&F	Biomase drusore	220	171	Diferenca 159 ktoc			

³ Nuk llogariten në Planin Kombëtar sepse janë ndërtuar tashmë dhe prodhimi i tyre mesatarisht varion në 4,200 GWh/vit.



	Total 2 (ktoe)	220	171		
	DIFERENCA 2018		49 ktoe		
BRE-T	<i>Biokarburante FAME</i>	61.8	20.3		
	Total 3 (ktoe)	61.8	20.3		
	DIFERENCA 2018		41.5 ktoe		
BRE Totali	Total 1+2+3 plan/fakt	233.8	182.3		
	HEC-et e mëdhenj	361.0	361.0		
	Total BRE	882	723		
	KFBE plan/fakt	2300	2070		
	% e BRE në KFBE	38%	35%		

Kështu, nga analiza e deritanishme, duke konsideruar konstante prodhimin me HEC-e të Kaskadës me 4,200MWh ose 361 ktoe, kemi këtë status:

1. HECV janë realizuar në masën 84% dhe mbeten akoma rreth 100 MW për tu komisionuar, të cilat janë të pritshme për tu realizuar, duke konsideruar kontratat e dhëna koncesionare, por që sipas parashikimeve të deritanishme, kurrresi nuk mund të ndërtohen brenda 2020-ës.

2. Fotovoltaiket (PV) janë realizuar në masën 60% dhe mbeten akoma për tu kontraktuar edhe 48 MWp, deri në vitin 2020.

3. Eoliket janë kontraktuar 32 MW pa mbështetje dhe janë dhënë autorizime paraprake për 9MW me mbështetje. Mbeten akoma për tu kontraktuar edhe 29MW. Nuk ka pritshmëri që këto objekte do të ndërtohen brenda vitit 2020.

4. **BRE-E për prodhimin e energjisë elektrike në total, kanë një shmangie të konsiderueshme prej 10 ktoe ose 11.6 GWh të munguara.**

5. **Biomasa drusore për ngrohje nuk ka pësuar shtesa gjatë 2018-ës, përkundrazi është reduktuar me 171 ktoe duke krijuar një diferencë me 41.5 ktoe, të cilat është e pamundur të rriten në vitet e ardhshme.**

6. **Biokarburantet janë zhvilluar gjatë 2018-ës me 20.3 ktoe dhe kanë krijuar një diferencë prej 41.5 ktoe.**

KONKLuzion: Totali i mosrealizimeve të pritshme krahasuar me trajektoren (tab. 1) e parashikuar në ligjin nr. 7/2017 për vitin 2018 është 100.5 ktoe.

2.5 Dhjetor 2018 - statusi i Objektivit Kombëtar 2020

Në maj të vitit 2009, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë filloi zbatimin e Direktivës 2009/28/BE në nivelin e vendeve kontraktuese të Traktatit, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Me vendimin e Këshillit të Ministrave të Traktatit,

2012/04/MC-EnC⁴, Shqipëria mori detyrimin për zbatimin e Direktivës së re për energjinë e rinovueshme 2009/28/EC. Në aneksin 4 të këtij vendimi, detyrimi për rritjen e përqindjes së energjisë së rinovueshme në konsumin total të energjisë (vit bazë, 2009) për Shqipërinë në veçanti, është konfirmuar 38% deri në vitin 2020.

Nisur nga sa më sipër, llogaritjet dëshmojnë se Objektivit Kombëtar gjatë viteve 2009–2018 ka qenë mjaft i paqëndrueshëm duke marrë vlerat minimale prej 25.8% (2011) në ato maksimale prej 35.6% (2015) deri në 34.5% në vitin 2018. **Kjo shpjegon edhe një herë faktin se Shqipëria bazohet kryesisht në prodhimin hidro të energjisë elektrike, prodhim i cili ka një impakt të konsiderueshëm në paqëndrueshmërinë e Objektivit Kombëtar të BRE.**


Duke interpretuar bilancin më të fundit energjetik për Shqipërinë, të nxjerrë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), për vitin 2018, nga një Konsum Final Bruto i burimeve primare të Energjisë KFBE prej 2,090 ktoe, 546.2 ktoe janë konsumuar nga burimet hidrike, të cilat për 2018-ën kanë qenë maksimale duke dëshmuar për një vit të “mbarë”; kontributi i biomasës dhe energjisë diellore për ujë të ngrohtë sanitar ka qenë përkatësisht 158.5 dhe 12 ktoe (total 170.5 ktoe) dhe konsumi i biokarburanteve ka qenë 20.3 ktoe. Totali i BRE-ve të konsumuara në territorin është i barabartë me 737 ktoe dhe përbën 34.8% të KFBE. Me poshtë, tabela 2 , e cila dëshmon për gjendjen e Objektivit sipas PKVBRE 2018–2020 në bilancin kombëtar të Konsumit të Energjisë për vitin 2018.

⁴ [https://www.energy-](https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Decisions)

[community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Decisions](https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/ENERGY_COMMUNITY/Legal/Decisions)

Tabela 2 – ecuria reale dhe parashikimet për 2019–2020 të trajektores së burimeve të rinovueshme në KFBE (ktoe)

ktoe	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-N&F	219.7	211.7	219.7	218.3	213.4	205.3	204.3	189.8	179.2	171	170.5	150
BRE-E	408	413.6	337.6	406.3	598.2	390.5	507.1	473.6	328.2	546.2	590	630
BRE-T	-	-	-	-	8.1	10.5	11	8.2	13.7	20.3	20.3	20.3
BRE Total	627.6	625.3	557.3	624.6	819.7	606.3	734.8	685.4	565.2	737	780.8	800.3
KFBE	2,104	2,106	2,162	2,014	2,346	1,994	2,065	2,056	2,070	2,090	2,090	2120
BRE %	30%	30%	26%	31%	35%	26%	36%	33%	27%	35%	37%	38%



SI KONKLUZION:

Sa më sipër analizuar në shifra, mund të arrijmë lehtë me konkluzionin se si do të jenë skenari për dy vitet e ardhshme për BRE-të, në raport me PKVBRE 2018–2020 është:

Tabela 3 - diferenca e realizimit të PKV/BRE 2018–2020 në (ktoe)

Teknologjia BRE	Objektivi 2020	Realizimi 2018	Diferenca deri 2020
BRE – Elektriciteti HEC	361	361	0
BRE – Elektricitet HECV	239	172	67
BRE – Ngrohje	220	171	49
BRE - Biokarburante	62	20	42
Totali	882	723	159



Kështu duke interpretuar tabelën:

Energjia e rinovueshme për sektorin e **transportit (BRE-T)** mbetet në kufijtë e **20.3** ktoe nga 62 ktoe të pritshme, dhe nuk BESOHE'T se do të ketë zhvillime të mëdha gjate 2 viteve të ardhshme;

Energjia e rinovueshme për **ngrohjen** dhe ftohjen (**BRE-N&F**) pritët të ulet për shkak të moratoriumit për prerjen e pyjeve për ngrohje, duke shpresuar të mbetet në kufijtë e 170 ktoe nga 220 ktoe të pritshme për 2020-ën;

Energjia e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (**BRE-E**) është realizuar me 172 ktoe, nga 239 të pritshme.

KONKLUZION:

Duke konsideruar se, qoftë Biomasa drusore dhe qoftë Biokarburantet nuk kanë gjasa të pësojnë rritje deri në vitin 2020, është e domosdoshme të plotësohen me teknologjitë të cilat kanë mundësi reale të kenë rritje.

E VETMJA MUNDËSI PËR TË ZHVILLUAR PROJEKTE TË BURIMEVE TË RINOVUESHME ËSHTË “BRE – ELEKTRICITETI”. Hapësira e krijuar është e barabartë me 159 ktoe.

Më poshtë le të shohim se cilët janë skenarët e mundshëm për të arritur Objektivin Kombëtar të BRE-ve për 2020 i cili është 38%.

3. Kostot konkurruese, për të prodhuar energjinë elektrike, nga BRE-të

3.1 Hidrocentralet e vogla (HECV)

3.1.1 Procesi i skanimit, janar 2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ndërmori me urdhrin nr. 47 dhe nr. 48, datë 30.1.2019, “Për verifikimin e zbatimit të kushteve të kontratave koncesionare dhe kontratave objekt i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, për burimet hidrike të energjisë”. Ky plan i detajuar i ashtuquajtur “Procesi i skanimit të situatës mbi korrektësinë e zbatimit të detyrimeve kontraktuale nga ana e subjekteve që kanë përfituar kontrata për ndërtimin e HEC-eve”. Urdhrrat adresuan problematikat e identifikuara deri më sot, ku më frekuentet ishin:

- Mosrespektimi i afateve procedurale;
- Mosrespektimi i kushteve ligjore dhe kriterëve në kontratat dhe lejet e lëshuara.

Meqenëse AKBN ka qenë aktori kryesor në procesin e monitorimit, është fokusuar në verifikimin e situatës në terren, ndërsa MIE në

praktikën dokumentare dhe në koordinimin e qëndrimeve me institucionet e tjera, si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për të dalë në konkluzionet finale mbi procedurat dhe hapat e mëtejshëm. Tre tipologji:

Në **tipologjinë e parë** janë përfshirë praktikrat, subjektet e të cilave janë ende brenda afateve kontraktuale për të vënë në funksion veprën, të cilat përbëjnë 44 kontrata koncesionare për ndërtimin e 92 HEC-eve dhe 57 kontrata objekt i VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, për ndërtimin e 61 HEC-eve;

Në **tipologjinë e dytë** janë përfshirë praktikrat të cilave u ka përfunduar afati kontraktual, subjektet e të cilave, ose: (a) kanë vënë një, apo disa HEC-e në operim, ndërsa një, apo disa të tjerë jo, ku përfshihen 20 kontrata koncesionare për ndërtimin e 60 HEC-eve dhe 1 kontratë objekt i VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, për ndërtimin e 3 HEC-eve; (b) kanë bërë investime të pafinalizuara, në mospërputhje me kontratën ku përfshihen 11 kontrata koncesionare për ndërtimin e 21 HEC-eve. **Problematikat e këtij grupi janë shkaktuar për arsye të burokracive administrative**, apo rrethanave që nuk varen nga subjekti po ashtu edhe si rezultat i mospërmbushjes, neglizhencës apo paligjshmërisë në veprim të subjektit. MIE do të adresojë këto problematika sipas rastit;

Në **tipologjinë e tretë** përfshihen praktikrat të cilat janë konsideruar me shkelje të rënda kontraktuale, të cilat ende nuk kanë filluar punime në terren, ose kanë filluar të ndërtojnë pa leje, ose janë braktisur për një kohë të gjatë. Në këtë grupim përfshihen 27 kontrata koncesionare për ndërtimin e 80 HEC-eve për të cilat është parashikuar ndërprerja e kontratës në mënyrë të njëanshme duke iu referuar shkeljeve përkatëse.

3.1.2 Mbështetja financiare për HEC-et e Vegjël deri në 15 MW

Para miratimit të ligjit nr. 7/2017, BRE-të në Shqipëri, janë dominuar nga skemat e mbështetjes financiare dhe mundësisë për aksesin në rrjet të energjisë elektrike të prodhuar nga **burimet hidrike** ose HEC-et e Vegjël (HECV). Gjithashtu mbështetja me kontratë 15-vjeçare, përveç tarifës së blerjes nga OSHEE, konsideron në fakt, një kontratë të parablerjes së energjisë (PPA-Power Purchase Agreement) e cila është siguri për financimin nga bankat, për investitorët. Situata dominuese në



tregun e gjenerimit të energjisë elektrike e krijuar nga këto HEC-e është e hershme, dhe lidhet posaçërisht me kontratat koncesionare, politike tarifore kjo, që dominoi në vitet 2005–2013. Pas shfuqizimit të ligjit nr. 138/2013, ligji i ri nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, është bazë ligjore për një sërë aktesh nënligjore lidhur me HECV-të, të cilat në raport me ligjin, **sigurojnë kontinuitetin e kontratave të mëparshme koncesionare** me qeverinë Shqiptare dhe japin mundësinë e dhënies nga ana e MIE, kapacitete gjeneruese deri në 2 MW për energjinë e HECV.

Në kuadër të konservimit ose **kontinuitetit të kontratave** koncesionare, ligji 7/2017 vendosi rregulla për prodhuesit ekzistues me përparësi, të cilët ishin HECV deri në 15MW. Kështu, mbështetur në nenin 22, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 7/2017, MIE ka propozuar VKM-në bazuar në nenin 10, të ligjit nr. 7/2017, nr. 687, datë 22.11.2017, “Metodologjia e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”. Ky çmim vjetor nga përllogaritjet e bëra sipas metodologjisë dhe i miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, i cili për vitin 2018 ka rezultuar në 8.46 lekë/kWh. Ky çmim do t’i paguhet prodhuesve privatë të HEC-ve nga ana e OSHEE-së me të cilin kanë tashmë kontratë. Në raport me vitin 2017 dhe 2016 kur çmimi ishte i njëjtë, fiksuar në 7.4 lekë kemi një rritje me 15%. Kjo përjasje merr në konsideratë kthimin e investimit i cili llogaritet për pjesën e mbetur të koncesionit.

3.1.3 Dhjetor 2018 - zhvillimi i HEC-eve të Vogla (HECV)

Lidhur me prodhimin e energjisë elektrike, në rajon Shqipëria përbën një rast të veçantë, sepse sot, prodhimi në vend realizohet 100% nga hidrocentralet e mëdhenj, të mesëm dhe të vegjël. Por, fakti që Shqipëria mbështet bazën e konsumit të energjisë elektrike, në energjinë hidrike, e bën atë vulnerabël ndaj ndryshimeve të kushteve hidrologjike, dhe **kjo gjë ka zvogëluar ndjeshëm sigurinë e furnizimit me energji elektrike.**

Kështu, pavarësisht luhatjeve, prodhimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet në vlera mesatare e 5-6 viteve të fundit është rreth 4,682 GWh. Ndërkohe viti 2018 ka qenë “spektakolar”

në prurjet e lumenjve, dhe Shqipëria prodhoi 8,870 GWh, duke tejkaluar prodhimin e pritshëm, duke plotësuar kërkesën për energji elektrike dhe duke eksportuar në fillimin e këtij viti. Ky vit e ktheu përkohësisht vendin tonë në eksportues të energjisë elektrike. Gjithsesi, pas vitit 2000 Shqipëria është importuese neto e energjisë elektrike, importet të cilat variojnë në varësi të kushteve, midis 25 dhe 30% të kërkesës për energji.

Nga një vështrim paraprak duket qarte se, pas aprovimit të ligjit nr. 7/2017 u krijua baza ligjore për mbështetjen financiare fikse për periudhën 15-vjeçare të HECV deri në 2MW. Kështu, përveç 171 kontratave koncesionare për 2,105MW, në MIE gjatë 2017-2018, janë nënshkruar edhe 71 kontrata për 78 HECV me fuqi totale 98MW. Kjo solli një stok të konsiderueshëm të HECV dhe, **në total janë dhënë 2,203 MW kapacitete gjeneruese të kontraktuara. Kështu, numër i HECV është 527 me një numër total të 251 kontratave.**

Referuar tabelës x të paraqitjes së kontributit të burimeve të rinovueshme për arritjen e Objektivit Kombëtar me 38% deri në 2020-ën, vlerësohet se ecuria e vënies në punë të Hidrocentraleve për periudhën 2015–2020, po ndjek këtë ritëm:

-Gjatë vitit 2015 kanë hyrë për herë të parë në prodhim 15 hidrocentrale të rinj, me fuqi gjeneruese të instaluar 65.87 MW dhe me prodhim vjetor 58,438 MWh/vit;

-Gjatë vitit 2016, kanë hyrë për herë të parë në prodhim edhe 15 hidrocentrale të rinj, me fuqi gjeneruese të instaluar 43.404 MW (ose 116.404 MW duke shtuar Banjën) dhe me prodhim vjetor 53.980 MWh/vit (ose 123,828 MWh/vit, duke shtuar Banjën e cila shet në treg të huaj);

-Gjatë vitit 2017 kanë hyrë për herë të parë në prodhim 6 hidrocentrale të rinj, me fuqi gjeneruese të instaluar 86.015 MW dhe me prodhim vjetor 48,555 MWh/vit;

-Gjatë vitit 2018 kanë hyrë për herë të parë në prodhim 19 hidrocentrale të rinj, me fuqi gjeneruese të instaluar 77.205 MW dhe me prodhim vjetor 64.841 MWh/vit (duhet thënë se kjo sasi do të rritet gjatë 2019-ës sepse këto HECV kanë hyrë për herë të parë në periudha të ndryshme të vitit).



Tabela 4 - në total gjendja për periudhën 2015–2018 ecuria e HECV-ve:

Viti	Nr. HECV në operim	Instalimi MW	Prodhimi MWh
2015	15	65.870	58,438
2016	16 (15+16=31 në total)	43.404 ⁵	123,828
2017	6 (31+6= 38 në total)	86.015	48,555
2018	19 (38+19=57 në total)	59.388	64,861
Totali²⁰¹⁸	57	254.7⁶ MW	295,7 GWh
Ongoing ²⁰¹⁸	94⁷		

Tabela 5 – Gjendja, dhjetor 2018, e ecurisë së HECV-ve që përfitojnë nga ligji nr. 7/2017, nën 2MW dhe VKM-ja nr. 822

2018 - Faza në të cilën ndodhet prodhimi i energjisë nga HECV	Numri i kontratave	Numri i HEC-ve	Fuqia e instaluar (MW)	Prodhimi i parashikuar në GWh	Vlera e investimit (miliard lekë)
Ska filluar ndërtimin	55	62	77.5 ⁸	199	10.2
Në ndërtim	13	13	16.60 ⁹	11.20	1.9
Në prodhim	3	3	3.90	4.9	0.30
Totali	71	78	98 MW	215 GWh	12

Tabela 6 – Gjendja e HECV-ve me koncesion

2018 - Faza në të cilën ndodhet prodhimi i energjisë nga HECV	Numri i kontratave	Numri i HEC-ve	Fuqia e instaluar (MW)	Prodhimi i parashikuar në GWh	Vlera e investimit (miliard lekë)
Ska filluar ndërtimin	67	209	1,070.91	3,633	115.17
Në ndërtim	28	71	158.58 ¹⁰	441	15.90
Në prodhim	85	169	875.30	14,458	48.60
Totali	180	449	2,105 MW	18,532 GWh	179.67

⁵ Hiqet fuqia e “Devolli HP”.⁶ Kjo e dhënë është aktualisht në punë sipas PKVBRE.⁷ Së bashku me koncesionet.⁸ Kjo e dhënë është kontraktuar dhe pritet të ndërtohet sepse ka marrë kontratë me tarifë të rregulluar sipas PKVBRE.⁹ Kjo e dhënë është kontraktuar dhe do të fillojë punë sipas PKVBRE.¹⁰ E prishme me mbështetje me koncesion që futet në inventarin e prodhimit të PKVBRE.



Nga të dhënat e mësipërme shihet se deri në 2020 pritët të shtohen këto kapacitete:

- 77.5 MW, HEC-e të Vegjël të kontraktuara sipas VKM-së nr. 822 nën 2MW të cilët nuk kanë filluar ndërtimin por gëzojnë të drejtën e ndërtimit ;
- 16.5 MW, HEC-e të Vegjël të kontraktuara sipas VKM-së nr. 822 nën 2MW të cilët kanë filluar ndërtimin ;
- 158.58 MW, HEC-e të Vegjël me kontratë koncesionare mbi 2MW të cilët kanë filluar ndërtimin ;
- 254.7 MW, HEC-e të Vegjël me kontratë koncesionare mbi 2MW, edhe sipas skemës mbështetëse të cilët kanë filluar prodhimin gjatë periudhës 2015-2018.

TOTALI prej 507.38 MW janë në fakt HECV brenda PKVBRE 2015–2020 të cilët kanë pritshmëri për të hyrë në punë deri në vitin 2020.

3.2 Foto Voltaiket (PV)

Për shkak të burimeve potencialisht të larta të energjisë diellore (mbi 1700 kW/m²/vit), në rajone të kufizuara të Shqipërisë, potenciali i pashfrytëzuar për vendosjen e PV në tokë jo pjellore është deri në 1,900 MW (p.sh. në toka të kripura deri në 3,500 ha). Ky burim është mundësia e “artë” që ka Shqipëria dhe tashmë, mund të konsiderohet, së bashku me energjinë Eolike si alternativa për diversifikimin e Burimeve të Rinovueshme në Shqipëri me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar për vitin 2020, 38%.

Çmimi i energjisë elektrike të prodhuar (€/MWh) ose LCOE, “kostoja e nivelizuar e energjisë elektrike” (“LCOE” - *Levelized Cost Of Energy*), në një investim PV influencohet nga: **kosto e kapitalit dhe influenca e riskut**. MIE, në metodologjinë e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, ka ndërmarrë një analizë më të plotë lidhur me kostot e kapitalit, duke konsideruar studimet e fundit që janë kryer në nivel ndërkombëtar, sidomos për vendet e rajonit të Evropës Juglindore të cilat kanë eksperiencë lidhur me PV. Studimet janë përqendruar në praktikën më të mira të IRENA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme) për vendet në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, dhe gjithashtu në studimin e ECOFYS 2017. Studimet janë: “Prodhimi e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me kosto konkurruese: Potenciali në

të gjithë Evropën Juglindore” (2017)¹¹ dhe “Hartimi i koston të kapitalit për Erën dhe Energjinë diellore në Shtetet Anëtare të Evropës Juglindore” – (2017)¹².

Lidhur me penetrimin me BRE-të në tregun e energjisë, ligji nr. 7/2017 parashikon që vlera totale e koston të investimit të mbulohet me “tarifën” përfaqësuese për çmimin mesatar që njësia gjeneruese duhet të marrë në një treg, për të kthyer investimin gjatë një periudhe të arsyeshme (neni 9, pika 6). Kjo vlerë e llogaritur është një vlerësimin ekonomik i rendit të parë të koston të konkurrencës së një sistemi (në këtë rast PV) të energjisë elektrike gjeneruese, që përfshin të gjitha shpenzimet e jetëgjatësisë ekonomike të impiantit.

Kostot përfaqësuese janë të lidhura me: (i) investimin fillestar; (ii) shpenzimet operimin dhe mirëmbajtjen; (iii) koston e lëndës djegëse e cila në rastin e sistemeve PV është zero; (iv) kosto të tjera fikse që, përgjithësisht kanë të bëjnë me taksat mbi përdorimin e tokës, taksat vendore, qira etj. sipas legjislacionit në fuqi, dhe (v) koston e kapitalit.

Kosto e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme ka vetëm një formulë që llogarit LCOE-në, e cila është vlera neto aktuale e të gjitha shpenzimeve gjatë jetës së njësisë gjeneruese, në raport (pjesëtuar) me prodhimin total të energjisë elektrike të njësisë gjatë të gjithë periudhës së punës deri në shkatërrim¹³. Formula për llogaritjen e LCOE merr në konsideratë: (i) I - Shpenzimet për investime në vitin t; (ii) M- O&M në vitin t; (iii) F - shpenzime fikse në vitin t, si taksa vjetore, përdorimi tokës, qira etj.; (iv) E - Energjinë elektrike të gjeneruar në vitin t; (v) r - Normën e interesit të koston të impiantit, dhe (vi) n - Jetëgjatësinë ekonomike të njësisë gjeneruese.

Duhet theksuar se në rastin e mbështetjes financiare, numri i viteve duhet të kufizohet për të reflektuar kohën e mbështetjes deri në

¹¹ January 2017 - IRENA, JOANNUM RESEARCH – “Cost-competitive renewable power generation: Potential across South East Europe” http://www.irena.org/DocumentDownloads/Publications/IRENA_Cost-competitive_power_potential_SEE_2017.pdf

¹² January 2017 - ECOFYS, ECLAEON “Mapping the cost of capital for wind and solar energy in South Eastern European Member States” <http://www.ecofys.com/files/files/ecofys-eclaeon-2016-wacc-wind-pv-south-east-europe.pdf>

¹³
$$COE = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + M_t + F_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}} = \frac{\sum \text{e kostove gjatë jetëgjatësisë}}{\sum \text{e energjisë elektrike të prodhuar gjatë jetëgjatësisë}}$$



vetëshlyerjen e investimit. Kjo do të thotë se LCOE duhet të konsiderohet për një periudhë më të shkurtër (max.15 vjet), periudhë e cila, kërkon detyrimisht një mbështetje financiare më të lartë, edhe pse jetëgjatësia e njësisë është më e madhe. Në këtë kontekst, duhet theksuar se zakonisht për gjenerimin e energjisë elektrike me teknologjitë me burime të rinovueshme, LCOE-ja llogaritet në jetëgjatësinë e projektimit të një njësie gjeneruese, e cila është zakonisht 20 deri 30 vjet për impiantet PV. Në mungesë të eksperiencës në këto impiante dhe të të dhënave të disponueshme për periudha më të shkurtra kohore, LCOE është e arsyeshme, që në rastin e PV, të llogaritet për një periudhë prej 10-15 vjetësh, periudhë gjatë të cilës impianti del me një fitim të konsiderueshëm.

Gjithashtu duke iu referuar studimeve në këtë fushë, të një prej kompanive më prestigjioze të Evropës ECOFYS, ka publikuar në janar 2017, studimin “Hartimi i kostos së kapitalit për Erën dhe Energjinë diellore në Shtetet Anëtare të Evropës Juglindore”, i cili ofron të dhëna të rajonit të Evropës Juglindore duke paraqitur koston e kapitalit për burimet e PV, si dhe koston e borxhit, raportit të borxhit me kapitalin neto dhe kapacitetin e instaluar.

Referuar raportit, studimi ka marrë në konsideratë koston e “riskut” të vendit, si edhe “riskun” e politikave energjetike për nxitjen e burimeve të rinovueshme të mbështetura me *feed-in-tariff* dhe *feed-in-premium*. Për çdo Shtet Anëtar, në rajonin e Ballkanit dhe, në mënyrë indikative tregohet se cila pjesë e koston së kapitalit është për shkak të “riskut” të vendit specifik, në krahasim me rreziqet, e për shkak të politikave të Energjisë së rinovueshme nën situatën e caktuar të tregut.

KONKLUZION: Nga analiza e bërë në metodologjinë e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, në raport me faktorët e mësipërm të konkurrueshmërisë, Shqipëria konsiderohet një vend me risk mesatar dhe ofron risk mjaft të ulët në Politikat e ndjekura. Analiza e bazuar në faktorët e mësipërm si: (i) potenciali PV me një mesatare 1,500 kWh/kWp; (ii) rajoni juglindor me toka të kripura dhe kosto të ulët të tokës; (iii) WACC¹⁴ në nivele 7.5% deri 8%, (iv) risk mesatar, çon në çmime konkurruese të energjisë për periudhën 15-vjeçare. Është tashme e vërtetuar, sepse me një

çmim të blerjes prej 100 €/MWh (p.sh. viti 2017) një impiant 2MWp i vendosur në zonën me 1,500 orë punë në pikë, do të kishte një “*cash-flow*” prej 300 k€/vit, çka do të thotë gjithashtu, se një impiant i tillë me vlerë fillestare investimi 1.3 M€ do të kishte një kohë minimale të vetëshlyerjes prej 4-5 vite.

3.2.1 Fotovoltaikët me mbështetje tarifore

Fotovoltaikët. Menjëherë sa filloi zbatimi i tij, ligji nr. 7/2017 mundësoi aplikime të menjëhershme në skemat promovuese deri në 2 MW për impiantet Foto-Voltaike (PV) dhe 3 MW për impiantet Eolike. Kërkesat u mbështetën në kapacitetet e propozuara në PKVBRE 2015–2020 (50MW – PV dhe 30MW – Eolike).

Me qëllim përcaktimin e një çmimi promovues për blerjen e energjisë, MIE propozoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme (dielli dhe era)” e cila u miratua me VKM-në nr. 369 datë 26.4.2017. Tre muaj më vonë, në 27.7.2017, ERE-ja miratoi këtë metodologji e cila përcaktoi tarifën promovuese 100 €/MWh për impiantet PV dhe 76 €/MWh për impiantet Eolik deri në 3 MW të instaluar. Kjo i hapi rrugë miratimit përfundimtar të lejes për ndërtimin e impianteve PV dhe lidhjes së kontratave për vitin 2017¹⁵. Janë gjithsej 11 kontrata të lidhura sipas tabelës 2.

¹⁴ Kosto mesatare të ponderuar të kapitalit.

¹⁵ Kontratat sipas çmimit të aprovuar nga ERE sipas propozimit të Metodologjisë së miratuar në VKM-në nr. 369, datë 26/4/2017.



Tabela 7 – kontrata të lidhura për PV deri në 2MWp

Nr.	Subjekti	Zona	Miratar, prot. dt.	Kontrata
1	AEE sh.p.k.	Grabjan, Lushnjë	MIE 3867/7 prot. 25.8.2017	2017
2	IN FOOD sh.p.k.	Gomsiqe Vau-Dejës	MIE, 4009/13 prot. 4.10.2017	2017
3	SEMAN 2 SUN sh.p.k.	Topojë ¹⁶ , Fier	MEI. 3888/2 prot. 29.12.2017	2017
4	SONNE sh.p.k.	Topojë Fier	MEI, 5585/8 prot. 11.9.2017	2017
5	SEMAN SUNPOWER sh.p.k.	Topojë Fier	MEI, 4115/3 prot. 28.12.2017	2017
6	OSOJA- ENERGY sh.p.k. SEMANISOLAR sh.p.k.	Topojë Fier	MIE, 3887/2 prot. 23.12.2017 MIE, 3245/1 prot. 20.4.2018	2017
7	RTS Sh.P.K.	Tren-Bilisht Korçë	MIE, 700/2 datë 10.11.2017	2017
8	AED SOLAR Sh.P.K.	Topojë, Fier	MIE, 5586/5 prot. 11.9.2017	2017
9	AGESUNPOWER sh.p.k.	Topojë, Fier	MIE, 5789/2 prot. 11.9.2017	2017
10	SMART WATT sh.p.k.	Topojë, Fier	MIE, 5864/11 prot.14.11.2018	2018
11	Person Fizik E. Xhoxhaj “Lugano”	Topojë ¹⁷ , Fier	MIE, 9310/2 prot. 19.12.2018	2018

Deri në 31 dhjetor 2018, në MIE janë paraqitur të paktën 75 aplikime për impiante PV deri në 2 MW, dhe 11 prej tyre janë pajisur me “Miratimin përfundimtar” dhe kanë nënshkruar kontratën me MEI/MIE për ndërtimin e impianteve me energji diellore për 100 EUR/MWh tarifë *Feed-In-Tariff* (FiT). Po kështu ankandi në Akerni, Vlorë, rezultoi i suksesshëm për 50 MW me mbështetjen e dhënë sipas parashikimeve të VKM-së nr. 349, datë 12.6.2018. Në PKVBRE 2018–2020 janë parashikuar 120 MW impiante diellore PV, nga të cilat 50+24=74 MW janë dhënë, dhe mbeten edhe 48 MW. Sikurse shihet në tabelën 5, bie në sy se rreth 18MW instalime PV janë dhënë me çmimet 100 EUR/MWh brenda vitit 2017 dhe thuajse në të njëjtën zonë (Sheq Marinëz, Topojë Fier).

Dy kontrata të reja duhet të presin çmimin e rishikuar të ERE-S për vitin 2018. Mirëpo ERE, pasi miratoi çmimet e vitit 2017, duhet të rishikonte këto çmime për vitin 2018 dhe 2019, bazuar në metodologjinë e mësipërme sipas parimeve të njohura të LCOE (*Levelized Cost Of Energy*) për skemat promovuese, si çmime të mbështetura në trendin rënës të kostove të këtyre impianteve në tregun ndërkombëtar dhe për të kthyer investimin në kohë të arsyeshme. Subjektet e paraqitura në tabelën 6, kanë përfituar autorizimin paraprak.

Tabela 8 – Miratime paraprake për PV deri dhe mbi 2 MWp

Nr.	Subjekti	Fuqia	Zona	Miratar, prot. dt.
1	N.T.S.P. sh.p.k.	2 MWp	Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë	MIE 5428/8 prot. 11.6.2018
2	KESH sh.a.	12.9 MWp	Mbi ujë, Vau i Dejës, Shkodër	MIE, 7466/8 prot. 31.12.2018
3	STATKRAFT Renewables Albania sh.p.k.	2 MWp	Mbi ujë Banjë, qarku Elbasan	MEI. 3888/2 prot. 31.12.2018

3.2.1 Orët në pikë që mbulojnë analizën përfaqësuese të zonave më fisibël për PV mbi 2 MWp

Për të vlerësuar nëpërmjet LCOE, termat për konkurrencën e PV mbi 2 MWp, krahasuar me tarifat e konsumatorëve të blerjes së energjisë me shumicë do të duhet të mbështetemi në të dhënat që ofron harta e potencialit PV¹⁸. Siç shihet potenciali diellor është mjaft i lartë krahasuar me vendet e rajonit në veri të Shqipërisë.

Sasia në pikë e energjisë elektrike të prodhuar, varion nga 1,200 deri 1,400 kWh/kWp. Ndërkohë në hartë vendet me më shumë potencial PV janë mes Karavastasë dhe derdhjes së Semanit të cilat janë toka të kripura dhe jo produktive. Kështu, analiza për këtë zonë të Shqipërisë, tregon se rrezatimi diellor (kWh/kWp) ose orë pune në pikë të sistemit PV, llogariten mes 1500 – 1600 orë në vit.

Qasja e përgjithshme e potencialit PV shprehet në hartën bashkëngjitur dhe përmban informacionin më specifik mbi supozimet dhe grumbullimin e të dhënave për çdo analizë të PV lidhur me

¹⁶ Zona Sheq Marinëz.

¹⁷ Zona Sheq Marinëz.

¹⁸ <https://solargis.com/maps-and-gis-data/download/albania>

vendndodhjen në territorin e Shqipërisë. Kjo e dhënë është në përputhje me mesataren e energjisë elektrike të prodhuar në harkun e një viti dhe rrjedh nga harta “*Albania - Photovoltaic Power Potencial*”.



3.3 Energjia e erës (Eolike)

Deri në 31 dhjetor 2018, janë dhënë në MIE 9MW (3x3MW) **impiante Eolike deri në 3MW** sipas skemës mbështetëse (76€/MWh) dhe 32 MW pa skemë mbështetëse. Në PKVBRE 2018–2020 janë parashikuar 70 MW kapacitete, nga të cilat mbeten pa u “konsumuar” edhe 29MW.

Megjithë këto zhvillime të fundit, shfrytëzimi i energjisë së erës në vendin tonë nuk ka filluar akoma, por ka një shprehje shumë të madhe interesi nga investitorët e huaj gjatë viteve 2009–2016 të cilët pjesërisht, kërkojnë të adoptohen me legjislacionin e ri (ligji 7/2017). Në këtë kuadër, janë në studim disa rajone të vendit tonë nga disa kompani të huaja.

Deri në fund të vitit 2016, nga ERE-ja, janë licencuar 15 kompani, për të prodhuar energji elektrike nga parqe me erë, me një fuqi të instaluar prej rreth 1,600 MW, të cilat shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri, e deri në rajonin e Sarandës në jug. Aktualisht, as një investim nuk ka filluar.

Si rezultat i këtij interesi deri në vitin 2017, që

kanë aplikuar për parqet Eolike 30 shoqëri, nga të cilat 7 prej tyre janë licencuar nga ERE-ja, më tej Ministria përgjegjëse për Energjinë ka dhënë 23 leje, ndërsa me autorizimin paraprak janë pajisur 16 shoqëri. Me vendim Qeverie është dhënë leja e ndërtimit për 4 shoqëri. Nga ERE në aktivitetin e ndërtimit, instalimit, të centraleve Eolike kane një afat 3-vjeçar dhe atë të prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar. Bie në sy kapaciteti i parashikuar për instalim që është 4,029.6 MW dhe totali i premtuar i investimit rreth 5 miliard Euronë licencuar.

Plani Kombëtar i Veprimit të Burimeve të Energjisë së Rinovueshme (PKVBRE) 2015–2020, parashikon kapacitetin e nevojshëm për të arritur objektivin kombëtar për vitin 2020, duke parashikuar instalimin edhe të 30 MW gjeneratorë Eolik. Në këtë parashikim deri tani nuk është ndërtuar asnjë impiant Eolik për gjatë 2015–2017 për arsye të kapacitetit të ulët që është vendosur në planin ekzistues, si dhe mungesa e zhvillimit të ankandeve të energjisë për erën. Kjo situatë kërkon rishikimin e PKVBRE në fund të janarit 2018.



Nr.	Shoqëria	Instalimi MW	Investimi M€
1	“HERA”	150	229
2	“ALB WIND ENERGY”	225	454
3	“BIOPOWER GREEN ENERGY”	230	250
4	“E-VENTO”	72	93
5	“UNIONE EOLICA ALBANIA”	150	149
6	“ERS-08”	40	43
7	“ENPOWER ALBANIA”	500	782
8	“Ned Green Energy”	72	57
9	“Windy”	50	78
10	“Wind Power Company”	28	48
11	“Running Energy”	27,6	27
12	“Energia Rinnovable”	75	136
13	“Biopower Green Energy”	108	160
14	“Re-Wind Albania”	72	75
15	“Re-Wind Albania”	66	70
16	“Re-Wind Albania”	30	30
17	“Wind Sun Water Initiative”	390	546
18	“Alb Building”	44	60
19	“Wonder”	22	30
20	“Elbavo”	38	42
21	“Era Milot”	36	54
22	“Elektromena Sh,P,K & Alba- Ndërtim”	50	67
23	“Alb Wind”	150	218
24	“Italian Wind Power Corporation”	270	-
25	“Power Wind Energy”	123	122
26	“En,Ergy”	738	819
27	“Energji” (Parku RADRIKA)	104	200
28	“Ionian Wind”	10	15
29	“Windcom Energy”	108	189
30	“Era”	51	80
	Totali	4029.6	5,125

Ligji i ri (7/2017) parashikon vendosjen e tarifave FIP (*Feed-In-Premium*) me anë të një procesi konkurrues, jodiskriminues të tenderimit (ankande) nëpërmjet Kontratave për Diferencë (CfD), ndërsa instalimet e reja mbi 3 MW për projektet Eolike, përjashtohen nga procesi konkurrues me çmimin tavan që do të vendoset bazuar në metodologjinë e aprovuar me VKM-në nr. 369 datë 26.4.2017 dhe të miratuar nga ERE-ja me vendimin nr. 120 datë 27.7.2017.

Potenciali i madh i energjisë Eolike në vende të limituara, por edhe kërkesa e lartë e investitorëve për tu investuar në kapacitete të larta, bën që rishikimi i kapaciteteve gjeneruese me impiante të prodhimit të energjisë elektrike, me energji nga era, të propozohet në nivele në 70 MW, siç e parashikon PKVBRE 2018–2020. Kjo sasi e limituar ka të bëjë me gatishmërinë e limituar, gjithashtu të rjetit për të akomoduar këtë sasi.

3.4 Prodhimi i energjisë elektrike nga pjesa

e degradueshme e Mbetjeve të Ngurta Urbane, industriale dhe rurale (MNU)

Biomasa nga mbetjet e cila përfaqësohet nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta urbane, përfshirë mbetjet biologjike (mbeturinat e biodegradueshme të kopshteve dhe parqeve, mbeturinat ushqimore dhe të kuzhinës nga familjet, restorantet, shërbimet e kateringut dhe ambientet e shitjes me pakicë, dhe mbetjet e ngjashme nga ndërmarrjet përpunuese ushqimore), gazi i landfillëve të grumbullimit të mbeturinave, pjesa e biodegradueshme e mbetjeve industriale (përfshirë letrat, kartonin, paletat) dhe llumi i kanalizimeve, potencialisht janë vetëm një mundësi për prodhimin e energjisë.

Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në 2013, kanë vlerësuar midis të tjerave, si detyrë kryesore reduktimin e mbetjeve nëpërmjet parandalimit, edhe shfrytëzimin e energjisë nga pjesa e



biodegradueshme e mbeturinave industriale, urbane dhe rurale nëpërmjet djegies. Mbetjet e djegshme përgjithësisht njihen si Mbetjet e Ngurta Urbane (MNU).

Gjithashtu, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, përcaktohet drejtimi i politikës së Qeverisë Shqiptare, për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve, deri në vitin 2025 është e ndarë në 3 faza operationale me nga 5 vjet secila. Në objektivat e 2013-ës strategjia parashikonte se deri në vitin 2015, u synua që 25% e mbetjeve bashkiake të riciklohej/kompostohet; deri në vitin 2020 synohet të ndalojë rritjen e mbetjeve bashkiake të prodhuara me riciklimin/kompostimin e 55% të mbetjeve bashkiake; dhe deri në 2025 të fillohet me rikuperimin e energjisë nga 15 % e mbetjeve bashkiake.

Nga tabela 1, është e qartë se **informacioni rreth sasive të disponueshme të biomasës është i pamjaftueshëm**. Gjithsesi gjate viteve 2015–2017 gjendja thuhet nuk ka ndryshuar, por pas vitit 2016 trendi i rënies së druve të zjarrit duhet të zëvendësohet me biomasën industriale, e cila parashikon djegien e mbeturinave në forme briketi dhe/ose pelet për qëllime të ngrohjes dhe konsumit energjetik industrial.

Kuadri ligjor për investime në energjinë e rinovueshme nga MNU-të është detyrë dhe masë të cilën PKVBRE 2015–2020 nuk e konsideroi, por ndërkohë, ligji nr. 7/2017 parashikoi instalimin e njësive të prodhimit të energjisë nga biomasa, ose ndryshe nga **pjesa e biodegradueshme e Mbetjeve të Ngurta Urbane**.

Gjithashtu, ligji i ri nr. 7/2017 i miratuar në shkurt të këtij viti, garantoj skemën e mbështetjes për burime të tjera nga energjitë e rinovueshme (përveç Hidro-ve) në kuadër të tregut të liberalizuar të energjisë elektrike dhe plotësimit të detyrimeve për të arritur objektivin kombëtar të BRE-ve me 38% në 2020. Përveç të tjerave, ligji parashikon vendosjen e tarifave FIP (*Feed-In-Premium*) me anë të një procesi konkurrues, jodiskriminues të tenderimit (ankande) nëpërmjet Kontratave për Diferencë (CfD), ndërsa instalimet e reja deri 2 MW, përjashtohen nga procesi konkurrues me çmimin tavan që do të vendoset bazuar në metodologjinë e MNU, tashmë të aprovuar me VKM-në nr. 27 datë 17.1.2018.

Si masë parësore në Strategjinë e MNU u

kërkua që mbetjet industriale dhe urbane të trashëguara nga e kaluara dhe të depozituara në disa venddepozitime të vendit, duhet të jenë prioritare për trajtimin dhe asgjësimin e tyre nëpërmjet teknologjive të pastra. Një nga masat në këtë drejtim ka parashikuar “Vendosjen e inceneratorit në afërsi të ndonjë prej fabrikave të çimentos për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe urbane për shfrytëzimin e energjisë së prodhuar për qëllime industriale të prodhimit”. Për më tepër ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e Burimeve të Energjisë së Rinovueshme” parashikon që teknologji të tilla kanë nevojë për mbështetje siç parashikohen në nenin 10, pika a, “.. *për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme për prodhuesit me përparësi, me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW*”.

Promovimi i këtyre lloj burimeve është një praktikë e njohur në vendet e BE dhe ka të bëjë me asgjësimin e mbetjeve të biodegradueshme, me qëllim prodhimin e energjisë (*Waste to Energy*). Sikurse edhe në këto vende, çmimi i blerjes së energjisë elektrike në Shqipëri nga çdo prodhues i kësaj natyre duhet të jetë promovues dhe në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

Gjithashtu në përputhje dhe si rekomandim në kuadër të “Zbatimit të Planit të Menaxhimit të mbetjeve 2010–2025” është krijimi i strukturave administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për forcimin e mëtejshëm të administrimit të mbetjeve. Sistemet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane, me mbetje mjedisore të ulët, që mbrojnë shëndetin dhe sigurinë e banorëve, parashikojnë përveç të tjerave, edhe asgjësimin e mbetjeve me qëllim prodhimin e energjisë, e cila krahasuar me landfillin, është teknologjia me impaktin më minimal në mjedis.

3.4.1 Tarifat e miratuara të MNU

Me VKM-në nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme, nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” është hedhur një hap tjetër për burimet e rinovueshme nga djegia e mbetjeve të ngurta



urbane (MNU) dhe rurale, duke kthyer mbeturinat e biodegradueshme në energji. Çmimet e propozuara nga MIE janë propozuar sipas metodologjisë LCOE (100 EUR/MWh). **Pritet së shpejti aprovimi nga ERE.**

3.5 Energjia nga Biomasa për ngrohje (BER-N&F)

3.5.1 Biomasa drusore

Pas marsit të vitit 2016, konsumi i druve të zjarrit ka rënë dhe pritët të bjerë në vitet 2019–2020 gjithashtu, dhe jo vetëm si rezultat i moratoriumit, por edhe si rezultat i rritjes së çmimeve për shkak të importeve të tyre, si edhe zëvendësimin e këtij burimi për ngrohjen me atë të energjisë elektrike. Konsumi i druve të zjarrit është ulur me rreth 55 ktoe gjatë periudhës 2015–2018 si rezultat i moratoriumit dhe shërben për plotësimin e 18-20% të nevojave për ngrohjen e popullatës.

Gjithsesi konsumi i vitit 2018 ka qenë rreth 160 ktoe dhe përfshin vetëm konsumin e druve të zjarrit të cilat përdoren në zonat malore urbane dhe

rurale. Lëndët djegëse të përpunuara të drurit, si ashklat e drurit, peletat dhe briketat, nuk janë në masivitet të përdorura, për shkak të çmimit të tyre të lartë dhe sistemit të pazhvilluar të furnizimit. Në mungesë të statistikave, besohet se gjatë viteve 2012–2016 është rritur në mënyrë të ndjeshme prodhimi i pelet për eksport, sidomos në Italinë fqinje.

Përdorimi i biomasës dominohet në zonat urbane dhe rurale të qarqeve si, Dibër, Kukës, Korçë dhe Gjirokastrë, ku të paktën 90% e familjeve ngrohen me lëndë drusore (biomasë pyjore) dhe më pak, në masën 10-12%, biomasa përdoret në qarqet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës dhe Fierit. Gjithsesi INSTAT ka publikuar se drutë e zjarrit kanë një kontribut 10-11%, thuajse konstant për vitet 2009–2016 dhe pas vitit 2016 kjo tendencë është në rënie me 9-7% në raport me KFBE.

Tabela 9 – INSTAT, Kontributi i druve të zjarrit në KFBE (ktoe)

Emërtimi / Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Kontributi %	10%	10%	10%	10%	9%	9.66%	10.9%	9.73%	8.7%	7.7%	7.0%	7.0%
Dru zjarri	213	205	208	207	202	193.2	225	200	180	160	150	150
Konsum final	2,104	2,106	2,162	2,014	2,122	2,090	2,065	2,056	2,060	2,070	2,120	2,120

Është e qartë se informacioni rreth sasive reale të disponueshme të biomasës është i pamjaftueshëm. Një raport i Bankës Botërore¹⁹, Komunitetit të Energjisë dhe WBIF, ka dalë në konkluzionin se Shqipëria ka shkallën më të ulët në rajon për ripërtëritjen e pyjeve.

Padyshim, INSTAT dhe AKBN duhet të bëjnë më shumë përpjekje për zhvillimin dhe implementimin e një sistemi informimi lidhur me burimet e biomasës drusore dhe sidomos kadastrës pyjore.

3.5.2 Biomasa nga bujqësia, pularia dhe mbetjet

Kultivimi i bimëve bujqësore për prodhim biomase në vendin tonë ka një potencial të kufizuar, për shkak të sipërfaqes së vogël të tokës

bujqësore, si dhe fragmentizimit të madh të saj. Megjithatë, edhe në kushtet aktuale, në disa kultura bujqësore, pjesë të tyre, si kashta, degët e prera nga krasitjet etj., mund të përbëjnë një burim të rëndësishëm, por është e nevojshme që potenciali i tyre të llogaritet dhe vlerësohet për kultura dhe zona të ndryshme të vendit. Potencial për prodhim energjie, përfaqësojnë edhe nënproduktet bujqësore dhe blegtorale si mbetje nga përpunimi, të tilla si bërsitë e ullirit, nga industria e përpunimit të vajit të ullirit, nga përpunimi i frutave të tjera, plehurat organike, në veçanti ato të pularive, nënproduktet nga përpunimi i peshkut, dhjami i kafshëve, mielli nga mishi dhe kockat etj.

3.6 Biokarburantet (BER-T)

Në Shqipëri biokarburantet kanë filluar prodhimin në vitin 2008 në përputhje me ligjin nr. 9876, datë 14.2.2008 si një risi për industrinë shqiptare të përpunimit të hidrokarbureve, kur bio-rafineria e parë në Shqipëri është ndërtuar në Porto Romano-Durrës. Ky impiant, pronë e shoqërisë *Green Fuel*, është një sipërmarrje e përbashkët e

¹⁹ “Biomass-Based Heating in the Western Balkans – A Roadmap for Sustainable Development” – 2017 https://www.energy-community.org/dam/jcr:90fc8f31-e5d0-433e-b8ab-21e10b172d28/WB_Biomass_heating_102017.pdf.



“Kastrati SHA” dhe “BPP s.p.a”, me një investim fillestar prej 5 milionë EUR. Impianti ka një kapacitet prodhues prej 120,000 ton në vit.

Produktet bazë të këtij impianti janë “Biodiezel” (dizel i përzierë - mishele me lëndë me prejardhje organike me origjinë bimore – vaj vegjetal) dhe Bioetanoli (benzinë e përzierë me lëndë me prejardhje organike, që prodhohet nga fermentimi i produkteve të pasura me sheqer – kallam sheqeri, panxhari i sheqerit etj.). Sidoqoftë, legjislacioni shqiptar dhe ai i BE njeh si biolëngje të djegshme për transport edhe Biogazin, Biometanolin, Bio-ETBE (Etil-Tercio-Butil-Eter), Bio-MTBE (Metil-Tercio-Butil-Eter), Bio-karburantin sintetik, etj. Mbi këtë bazë, politika shtetërore formulohet me ligjin nr. 9876/2008 “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të para djegëse, të rinovueshme, për transport” ka përcaktuar sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme që duhet të tregtohen për sektorin e Transportit.

Gjithsesi në fillim të vitit 2019 është ndërmarrë një iniciativë ligjore nga MIE për të ridërguar në Këshillin e Ministrave një projektligj të titulluar “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”. KM-ja, në datë 3.7.2019 aprovoi me VKM, dërgimin e ligjit në Parlament. Praktikisht ligji është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/28/KE, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 prill 2009, “Mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme”.

Arsyetime për iniciativën ligjore lidhet me faktin se ligji ekzistues nr. 9876, datë 14.2.2008 është përpiluar në përputhje me Direktivën 2003/30 e cila është zëvendësuar me kërkesa të Direktivës 2009/28. Ndërkohë, Direktiva 2003/30/EC²⁰ e BE-së, synonte përdorimin e biodizelit, si mjet që zëvendëson naftën apo benzinën për transport, kjo si masë mbrojtëse për sigurinë e sjelljes miqësore me mjedisin për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në këtë sektor (BER-T).

Në kuadër të KKP-ve (NDC-ve), për reduktim të gazeve me efekt serre në sektorin e Transportit, ligji ka qëllim promovimin e kontributit në përmbushjen e angazhimeve për emisionet e gazeve që vijnë nga konsumi i hidrokarbureve në

këtë sektor. Për Shqipërinë, Transporti është kontribuesi më i madh i CO₂ në transportin rrugor dhe llogaritet të jetë 740 kton në vitin 2016 dhe 690 kton për 2018-ën, të cilat dhe në përmasat e vendit, ndikojnë ndjeshëm në ndryshimet klimatike.

Pa hyrë në analizën e tregut me pakicë në vitet 3 vitet e fundit janë konsumuar vetëm 15-20 kton në vit për qëllime transporti me standarde të njohura nga organet kompetente vendase. Sasia e hedhur për konsum për vitin 2016–2017–2018 për produktin Biodizel, sipas kodeve doganore është si në tabelën 7.

Tabela 10 - Të dhëna të IQT

Viti	Produkti 7% FAME	Sasia (ton)	FAME (ton)
2016	Gazoil SSHEN 590:2103	115,263	8,068
2017	Gazoil SSHEN 590:2103	196,000	13,720
2018	Gazoil SSHEN 590:2103	210,300	20.360

Së fundi, MF konfirmon se në Shqipëri është konsumuar 20.4 kton, gjatë 2018, e cila ka shkuar për sektorin e transportit. Përzierja e lëndëve energjetike të rinovueshme nuk i kalon 3%.

3.7 Përmbledhje e politikave dhe masave për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme BRE. Politikat e diversifikimit të BRE-ve në Shqipëri?

Duke treguar vëmendjen e duhur MIE, në kuadër të ligjit nr. 7/2017, ka promovuar dhe inkurajuar burime të tjera të energjisë për të filluar me kontrata parablerjeje të energjisë elektrike për vepra gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni, duke dëshmuar kështu për politikë diversifikuese të burimeve të energjisë të rinovueshme. Kjo edhe për shkak të avancimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me teknologji të ndryshme nga ajo që dominon sot prodhimin vendas të energjisë elektrike, vetëm me burimet hidro, si edhe uljes së shpejtë të kostove për prodhimin e energjisë elektrike, nga energjia diellore (PV) dhe e erës, të cilat janë globalisht burimet kryesore të shtimit të kapacitetit të energjisë në tregun me shumicë.

Kështu, nga pikëpamja e investimit, impiantet diellore dhe të erës mund të ndërtohen në rreth 12 muaj, në bazë të kapacitetit, ndërsa ato hidro kërkojnë më shumë se 4-5 vjet. Meqenëse objektivat duhet të arrihen brenda 1.5 viteve, është e domosdoshme të orientohemi drejt burimeve që mund të krijohen në korniza më të shkurtra kohore.

²⁰ E zëvendësuar nga Direktiva 2009/28/EC.



3.7.1 Objektivat Strategjike të Politikave të rekomanduara për BRE-të

Me zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, Shqipëria synon të arrijë rezultate edhe më të avancuara lidhur me BRE-të. Qeveria është zotuar për një politikë të rritjes së përdorimit të energjisë së rinovueshme, kryesisht të energjisë hidrike, diellore dhe të erës. Në veçanti, qeveria:

- Do të garantojë që nivelet e burimeve të rinovueshme të energjisë të ofruara në treg, të jenë të menaxhueshme në kuadrin e burimeve të tjera të energjisë elektrike dhe të tregut në zhvillim;

- Ka tashmë përvojë të gjerë në vënien në funksionim të projekteve të hidrocentraleve të vogla nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit. Projekte të tilla hidrike do të vazhdojnë të respektohen si një përvojë shumë e madhe. Megjithatë, për projektet e centraleve diellore dhe të erës ka pak përvojë të mëparshme, Qeveria ka përcaktuar tarifa nxitëse (Feed-in Tariff) për energjinë diellore, të erës në mënyrë që të promovojë zonat më të mira dhe në të njëjtën kohë, të ndihmojë në arritjen e objektivave përkatës për përdorimin e burimeve të rinovueshme;

- Zhvillimi i një tregu rajonal do të çojë në një ndryshim më të madh të çmimeve gjatë ditës, sezonit (dimër-verë) dhe duke optimizuar shfrytëzimin e HEC-eve me impiantet e vegjël diellorë fotovoltaik dhe të erës, për të ndihmuar në diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë diellore dhe të erës, Shqipëria do të rrisë ndjeshëm përfitimet në nivel vendi.

Objektivat strategjike të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e potencialeve të burimeve të rinovueshme të energjisë janë:

- Rritja e përdorimit të teknologjive të BRE, bazuar në planifikimin me kosto minimale, metodologji për çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga teknologji për prodhimin e energjisë elektrike bazuar në koston e niveluar afatgjatë (LCOE) dhe kthim të investimeve në kohë të arsyeshme.

- Të sigurojë diversifikimin e burimeve të rinovueshme, duke u investuar në sisteme komplementare me kosto të ulët, siç janë PV dhe Eolike.

- Zhvillimi i mekanizmave për nxitjen e investimeve të huaja direkte në BRE, bazuar në skema të organizimit të ankandeve për kapacitete mbi 2 MW që ofrojnë shfrytëzimin e burimeve të

pashfrytëzuara deri më sot, siç janë Sitemet Diellore PV dhe fermat Eolike.

3.7.2 NDC dhe veprimet për ndryshimet klimatike

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit më 22 Prill 2016, duke hyrë në epokën e re të procesit të politikës ndërkombëtare të klimës. Shqipëria iu bashkua Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 1995 dhe Protokollin e Kiotos në vitin 2005. Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit, nga një vend në zhvillim, në një vend të zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC. Ky proces është pjesë integrale e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të gazrave me efekt serrë (GHG), formulimin dhe zbatimin e politikave për të reduktuar GHG dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e *acquis*-it të Bashkimit Evropian për ndryshimet klimatike. Në përputhje me objektivat e BE 20-20-20, Shqipëria ka paraqitur Kontributin Kombëtar të përcaktuar brenda procesit të Marrëveshjes së Parisit në shtator 2015, duke u angazhuar për të reduktuar emetimet e CO₂, krahasuar me skenarin bazë në periudhën 2016 dhe duke synuar një reduktim me 11.5 % në vitin 2030. Niveli i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar do të rishikohet dhe do të përpunohet më tej sipas Planit të Integruar të Energjisë dhe Klimës që do miratohet në 2020.

4. Konkluzione dhe rekomandime

4.1 Sasitë e BRE-ve të domosdoshme për të realizuar Objektivin Kombëtar 38%

Si pikënisje, në Objektivin Kombëtar për BRE, do të jetë viti 2009 në të cilin KFBE ka qenë 2,104 ktoe dhe përqindja e BRE-ve në terma konsumi ka qenë 29.5%. Duke përdorur metodën e përcaktuar në Direktivë, sipas teknologjive jepen të dhenat bazë për promovimin e BER:

4.1.1 Energjia e rinovueshme për sektorin e transportit (BRE-T)

Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE-ve prej 38% në vitin 2020, është e domosdoshme prodhimi në territorin e Shqipërisë të sasisë prej 3% të KFBE. Duke qenë se kjo sasi është e barabartë me të paktën 65 ktoe (65,000 ton/vit FAME) në për sektorin e transportit në vitin 2020 dhe kjo sasi konsiderate



rritjen me të paktën në 20,000 ton krahasuar me 2018. Në **pamundësi reale për të konsumuar këtë sasi PKKVBRE 2019-2020 merr në konsideratë vetëm 20 ktoe të cilat ka pritshmëri të konsumohen.**

4.1.2 Energjia e rinovueshme për ngrohjen dhe ftohjen (BRE-N&F)

Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE prej 38% në vitin 2020 është e pamundur rritja e konsumit nga biomasa drusore KFBE dhe kjo reflektohet, jo vetëm 0% rritje por rënie me 55 ktoe në sektorin e Ngrrohjes dhe të Ftohjes, BRE-N&F. Në **pamundësi reale për të konsumuar sasi shtesë, PKKVBRE 2019-2020 merr në konsideratë vetëm 160 ktoe për të cilat ka pritshmëri të konsumohen deri në 2020.**

4.1.3 Energjia e rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike (BRE-E)

Me qëllim arritjen e Objektivit Kombëtar të konsumit të BRE-ve, prej 38% në vitin 2020, është e domosdoshme një rritje e sasisë shtesë të konsumuar të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, me të paktën 159 ktoe deri në vitin 2020. **Kjo sasi mbulon edhe deficitet e krijuara nga BRE-të dhe BRE-N&F.**

4.2 Sasitë e BRE-ve në Planin e Konsoliduar

Më poshtë tabela 11, përmbledhëse e BRE-ve për Ngrrohjen/Ftohjen, Transportin dhe Energjinë Elektrike që shtohen gjatë vitit 2019 deri në fund të vitit 2020 në Konsumin Final Bruto të energjisë në Shqipëri.

Teknologjitë shtesë të BRE 2018-2020		2018	Shtesat 2019-2020		
		Fakti (ktoe)	Sasia (ktoe)	Gjenerimi (GWh)	Instalimi (MW)
Zgjerimi me BRE-E	HECV deri në 15 MW	126	18.6	217	57
	Eolike (Wind)	0	47.7	555	150
	Fotovoltaike (PV)	0	68.0	784	490
	MNU	4	17.7	205	41
	Total 1 përfshirë në PKVBRE	130	152.0	1,761	738
BRE-N&F	Biomase drusore Total 2 (ktoe)	0	0		
BRE-T	Biokarburante Total 3 (ktoe)	20.3	20.0		
BRE	Total 1+2+3	150.3	172.0		
Totali	HEC + HECV (në operim 2018)	573.0	634.0	7,369	2,170
	Total BRE	723.0	806.0		
KFBE plan 2020		2070	2,120		
% e BRE në KFBE		35%	38 %		

4.3 Investimet në BRE dhe llogaritja e tarifave të rregulluara

Për të përmbushur kërkesën në rritje për energji elektrike dhe për të zvogëluar nivelin e importit, janë përgatitur skenarët e vendosjes së ndryshimeve të kapaciteteve të BRE-E sa më sipër përmes modelit tekniko-ekonomik që shërben për të identifikuar një plan të ri për zgjerimin e centraleve për secilën teknologji BRE-E, bazuar në një kosto minimale të gjenerimit të njësisë së energjisë elektrike.

Përmbushja e kërkesës për energji elektrike parashikohet bazuar në skenarin e kombinuar të Strategjisë. Kështu, kostoja e investimeve të prodhimit përcaktohet nga kostot e investimit për secilin central elektrik në planin e zgjerimit dhe bazohen në të dhënat aktuale sipas shumë studimeve të fizibilitetit për HEC-et e vegjël, HEC-et e mesme dhe të mëdha, impiantet e prodhimit të energjisë nga era, ato fotovoltaike, duke përdorur vlera mesatare për investimet specifike për teknologjitë përkatëse. **Këto impiante duhet të zgjerohen me prodhim të energjisë elektrike sipas parashikimeve të SKE 2030 për plotësimin e nevojave të Shqipërisë në vitet e ardhshme për BRE-të:**

Tabela 12

Viti	2018	2020	2025	2030	totali
Energji elektrike (GWh) - kombinuar (ktoe) në total	7,358 632	7,854 675	8,178 703	8,616 741	
Zgjerimi me kapacitete BRE (MW)	220	519	140	222	1,100

Kostoja e investimit për zgjerimin e sistemit të transmetimit të tensionit të lartë, duke përfshirë rrjetet 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, bazohet në informacionin e kostos së përfshirë në Parashikimin e Kërkesës për Energji nga OST, të cilat deri në fund të 2030 investimet sipas SKE2030 do të jenë 157 MEUR. Shpenzimet e investimit për sistemin e shpërndarjes (OSSH) që përfshijnë parashikimet e SKE2030 si: a) përmirësimin e sistemit të shpërndarjes për të përmirësuar besueshmërinë; b) investimet e synuara në rrjetin e tensionit të mesëm (6-20 kV); c) investime në pajisjet për matjen e konsumatorëve; d) sistemin për matjen në rrjetin e tensionit të ulët; dhe e) përmirësimin e menaxhimit të informacionit dhe të sistemit të faturimit dhe arkëtimit. Investimet kumulative të OSSH-së, të parashikuara në SKE, për periudhën 2018–2030, do të jenë 338 MEUR.

4.3.1 Llogaritja kumulative e financimeve për 2019–2020

PKKVBRE 2018–2020 është një plan shumëdimensional me një horizont planifikimi afatshkurtër (2018–2020), që përfshin sektorët e BRE-ve, politikës dhe rezultateve të planifikimit afatgjatë në SKE2030. Tabela jep një indikacion të huazuar nga SKE2030 dhe e adoptuar në PKKVBRE, i cili është hartuar me parimin që të ketë një ndikim minimal në shpenzimet publike, duke parashikuar se investimet që vijnë nga burime private, bankat e zhvillimit, asistencë teknike e huaj dhe, së fundmi, nga buxheti i shtetit.

Tabela 13: Kërkesa totale e investimeve kumulative 2018 – 2020

Aktivitete të Sektorit të BRE	M EUR	
	EUR/MW	Total
SEKTORI ELEKTROENERGJETIK		
Prodhim nga BRE-E		
HECV (57MW)	1,2	68.5
PV (480MWp)	0.6	288.0
Eolik (150MW)	1.1	165.0
MNU (41 MW)	1.5	61.5
Mesatare/Totali	0.8 EUR/MW	583 MëEUR
Mbështetja e BRE nga tarifat e rregulluara		
Projektet e Ndërgjegjësimin të BRE dhe Projektet Pilote		5
Mbështetje financiare për BRE deri në 2018–2020 FiT ²²	0.018	70
Mbështetje financiare për BRE deri në 2018–2020 FiP (KpD)	0.009	45
Totali i financimeve nga tarifat e energjisë deri në 2020		120

Tabela 13, e cila tregon se investimi i kërkuar për të gjithë nënsektorin e energjisë nga BRE-të për të gjithë periudhën 2018–2020, paraqet dhe ndarjen sipas investimeve. Tabela tregon se investimi total më i lartë është për sektorin e energjisë elektrike me mbështetje të drejtpërdrejtë nga sektori privat (583,0 M EURO) nëpërmjet dhënies së të drjetës për të ndërtuar kapacitete gjeneruese me HEC-e, PV, Eolike dhe MNU.

4.3.2 Parametrat tekniko-ekonomike të teknologjive që përcaktohen në metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë nga PV, Eolike dhe HECV për BRE-E

Më poshtë tabela 14 ka një përmbledhje të kostove të investimit për tre llojet kryesore të teknologjive të BRE-E të parashikuara në PKKVBRE 2018–2020:

Shënim: Pjesa e tarifës Feed-in-Tarif (FiT) dhe Feed-in-Premium ose KpD është llogaritur mbi një çmim mesatar me shumicë që OSSH e ble nga tregu i rregulluar, supozim ky për qëllime të llogaritjes së kostove shtesë mbi këtë çmim, që konsiderohet mbështetje tarifore.



Tabela 14- Konsideratat tekno-ekonomike për Energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-E.

	Centrale fotovoltaike (PV) deri 2MW dhe ankand	HECV deri 15MW me koncesion dhe deri 2MW	Centrale me erë (Eolike) deri 3MW dhe ankand
1.	Kapacitetet gjeneruese të impianteve që shfrytëzojnë BRE propozohen të jenë mjaftueshëm për arritjen e objektivit 38% sipas PKVBRE 2015–2020 dhe PKKVBRE 2018–2020 të BRE-ve		
2.	Metodologjia e skemave mbështetëse, sipas kapacitetin të impiantit të BRE-ve, aprovet me VKM sipas ligjit nr. 7/2017		
3.	Skemat mbështetëse për PV deri 2MW me tarifë të rregulluar <i>feed-in-tariff</i> (FiT). për 2017 çmimi ka qenë 100€/MWh. Nuk ka vendim të ERE për 2018-2019-ën	Skemat mbështetëse për HECV janë 2 lloje: (i) Prodhues me përparësi me çmim 8.56 lekë/kWh dhe Prodhues deri në 2 MW akoma nuk ka VKM për metodologjinë e çmimit	Skemat mbështetëse për Eolike deri 3MW janë me tarifë të rregulluar <i>feed-in-tariff</i> (FiT). Për 2017 çmimi ka qenë 76€/MWh. Nuk ka vendim nga ERE për 2018-2019-ën
4.	Skemë mbështetëse me ankand për kapacitete mbi 2MWp jepet për KpD. 50MWp. Në Akerni çmimi ishte 59.9 €/MWh	Nuk aplikohet në skema mbi 15MW me ankand dhe KpD. Nuk ka praktika të ngjashme	Skemë mbështetëse me ankand për kapacitete mbi 3MWp jepet për KpD. Nuk ka praktikë të ngjashme
5.	Rrezatimi vjetor diellor për orët “pik” varion nga 1400-1700 orë punë në pik/vit.	Prujet mesatare vjetor të ujit për lumin përkatës të përdoret për përcaktimin e orëve të punës (3000-3500 orë/vit)	Shpejtësia mesatare vjetore e erës për vendin përkatës. Janë 3500-4000 ore/vit
6.	Vlerat mesatare të investimeve janë maksimalisht 450-550 mijë €/MW për kapacitet mesatar.	Vlerat mesatare të investimeve janë 1,000-1,550 mijë €/MW për kapacitet mesatar.	Vlerat mesatare të investimeve janë 1,250-1,650 mijë €/kW për kapacitet mesatar.
7.	Operimi dhe mirëmbajtja janë 1,2-1,5% të investimit fillestar.	Operimi dhe mirëmbajtja të SHPP, janë 1,7-2% të investimit fillestar.	Operimi dhe mirëmbajtja të WPP-ve, janë 1,5-1,7% të investimit.
8.	Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC), e konsideruar në llogaritjen e KpD për BRE duhet të jetë të paktën 8-10%. Kapitali i investitorëve 25-30% të totalit të investimeve bazuar në Konceptin e Projektit.		
9.	Kohëzgjatja e stimujve: Furnizuesi Publik (OSHEE) lidh një marrëveshje blerjeje (PPA-Power Purchase Agreement) 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare me të gjitha centralet prioritare BRE të pranuar në skemën mbështetëse; po kështu OSHEE blen energji elektrike me tarifën e energjisë së rinovueshme bazuar në konceptin e KpD.		
10.	Procedurat e licencimit: Procedurat e autorizimit janë pothuajse të njëjta për BRE nën 2MW me PV, nën 3MW me Eolike dhe nën 2 MW për HECV. Kjo procedurë bëhet brenda Ministrisë përgjegjëse për Energjinë. KpD ndikohet nga procedura e dhënë me 822-shin dhe ligjin për koncesionet.		

18.7.2019

**URDHËR****Nr. 517, datë 3.9.2019****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj, për datën 4.9.2019.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Brendshme, z. Julian Hodaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

KËRKESË**Nr. 7714, datë 2.9.2019****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i rrugës ‘Isuf Balta’, Tiranë”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e Hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 51,306,408 (pesëdhjetë e një milion e treqind e gjashtë mijë e katërqind e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI

“Ndërtimi i rrugës ‘Isuf Balta’, Tiranë”

Nr.	Emër, Atësi, Mbiemër	Pjesët takuese të bashkëpronësisë	Z. K	Nr. pasurie	Sip. përgj. truall m ²	Sip. prekur truall m ²	Çmimi truall lekë/m ²	Sip. totale e objektit m ²	Sip. e objektit të prekur m ²	Çmimi për objekt lekë/m ²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (Objekt i prekur) lekë	Vlera (truall+objekt) lekë	Konfirmimi i ZVRPP Tiranë	Shënime
1	Shtet		8330	2/1	4610	25	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
2	Shtet		8330	3/730	123	32	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Islam Shaban Mehmeti, ka dy ndërtime të paligjshme
3	Maliq Riza Bici		8330	3/407	320	119	34068				4054092		4,054,092	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka dy ndërtime të paligjshme
4	Flamur Bahir Flamuraj Bashkim Xhemal Toska Halit Jonus Elezaj	1/3 1/3 1/3	8330	3/418	72	13	34068				442884		442,884	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka një ndërtim të paligjshëm
5	Ardian Bejko		8330	3/419	328	91	34068				3100188		3,100,188	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Ka dy ndërtime të paligjshme
6	Bujar Zyber Skënderi Hysni Zyber Skënderi Liri Skënder Sinani Mahmudie Zyber Shkalla Nezhmie Skënder Fortuzi Sulltane	1/6 1/6 1/6 1/6 1/6 1/6	8330	3/883	1826	723	34068				24631164		24,631,164	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Mbi këtë pasuri bie ndërtesa nr. 3/89-ND, vol. 51, fq. 178, përfituar me leje legalizimi



	Skënder Kazani													
7	Rezar Bujar Sula Eduard Bujar Sula Vildon Skënderi Pëllumb Skënderi Zana Prifti Pranvera Beqaj Mimoza Skënderi Zeliha Musi Haxhi Demir Mereme Dervishi Fatmir Demiri Fitnete Novosela Nexhmije Dedja Nimete Bilbili Bukurije Shijaku Shefqet Bega Gëzim Duraku Qëndresa Duraku Nazmije Caslli Mereme Allushi Fiqirete Bega Ervin Bega Shyqyri Skënderi Ismail Skënderi Lumturi Çoku Aishe Mumajesi Fatbardha Kazani Afërdita Skënderi Ardian Skënderi Sokol Skënderi Meriban Demiri Adriana	8330	3/891	3644	473	34068					16114164		16,114,164	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019. Në përshkrimin e veçantë citohet: Sipërfaqja prej 542 m ² është pjesë e rrugës Isuf Balta, nuk është lëshuar certifikatë e pronës. Sipas VKM-së së shpronësimit nr. 220, datë 23.3.2016. Janë shpronësuar prej 73.4 m ² në favor të Blerim Ramazan Ahmataj. Në seksionin “D” ka shënimet: Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. Pasurie 3/913-nd, vol. 49, fq. 78. Mbi këtë pasuri, bazuar në lejen e legalizimit është regjistruar ndërtesa me nr. pasurie 3/589-nd, vol. 52, fq. 9, zk. 8330. Mbi këtë pasuri pozicionohet ndërtesa nr. 3/955-nd, vol. 52, fq.19.



	Hasibia Mehmet Demiri													
8	Arjan Medi Malushi Florent Dashnor Malushi Lelant Dashnor Malushi Olti Dashnor Malushi Roland Dashnor Malushi	2/6 1/6 1/6 1/6 1/6	8330	3/780	400	34	34068			1158312		1,158,312	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Në seksionin D ka shënimin mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa 3/955-nd, vol. 52, faqe. 19
9	Shtet		8330	38595	654	112	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
10	Shtet (Shesh)		8330	3/612	79	46	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
11	Shtet		8330	3/609	101	5	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Ilia Fari Beshelo, ka një ndërtim të paligjshëm
12	Shtet		8330	3/97	107	18	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Vullnet Shefki Taque, ka një ndërtim të paligjshëm
13	Shtet (Rrugë)		8330	3/602	746.2	418	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
14	Shtet		8330	3/109	326	9	0			0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot.,	Kjo pasuri është e okupuar nga Shaban Mexhit



														datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Koltraka, ka një ndërtim të paligjshëm.
15	Shtet		8330	3/107	246	39	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Blerta Malik Loci, ka një ndërtim të paligjshëm
16	Shtet		8330	3/601	338.3	23	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Servet Njazi Ibrahimi, ka një ndërtim të paligjshëm
17	Mevlud Metush Ndreu		8330	3/101	283.2	19	34068	45.9	0	0	647,292	0	647,292	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
18	Nuri Xhika, Kujtim Plaku		8330	3/605	303	19	34068	130.9	0	0	647,292	0	647,292	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
19	Shtet		8330	3/604	150.64	2	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Saimir Nuri Xhika, ka një ndërtim të paligjshëm.
20	Shtet		8330	3/103	391	35	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Skënder Hodo Xhaferasi, ka një ndërtim të paligjshëm
21	Shtet		8330	3/102	200	14	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Hajri Hodo Xhaferasi, ka një ndërtim të paligjshëm.



22	Bilbil Hodo Xhaferasi		8330	3/600	200	15	34068	86.1	0	0	511,020	0	511,020	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	
23	Shtet		8330	3/613	143	4	0				0		0	Konfirmohet me shkresat nr. 45684/1 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 3696/1 prot., datë 13.2.2019.	Kjo pasuri është e okupuar nga Sulejman Haxhi Xheqi, ka një ndërtim të paligjshëm
Vlera totale paraprake e shpronësimit							2,288				51,306,408		51,306,408		

**KËRKESË****Nr. 5172/4, datë 2.9.2019****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 19, datë 16.1.2019, ‘Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, qendra e qytetit Roskovec”””.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Roskovec.

Me anë të këtij publikimi, kërkohmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky

shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, dhe vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, i ndryshuar, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “njësi shërbimi”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 6,319,662 (gjashtë milion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VKM-në NR. 19, DATË 16.1.2019

Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, Qendra e qytetit Roskovec”

Nr.	Emër ,	Atësi,	Mbiemër	Nr. pasurisë	ZK	Sip. Truallit e prekur m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e truallit	Sip. e ndërtesës së prekur	Çmimi i ndërtesës lekë/m ²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale	Shënime sqaruese
1	Bashkepronaret: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli			2/362	3196	85	494	41990	0	30000	0	41990	Vërtetim hipotekor
2	Bashkepronaret: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli			2/363	3196	147	494	72618	0		0	72618	Vërtetim hipotekor
3	Bashkepronaret: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli			2/352	3196	144	494	71136	0		0	71136	Vërtetim hipotekor
4	Bashkepronaret: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli			2/353	3196	375.5	494	185497	0		0	185497	Vërtetim hipotekor
5	Bashkepronaret: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli			2/354	3196	153	494	75582	0		0	75582	Vërtetim hipotekor
6	Qani Haxhi Vidhishta			2/351	3196	72	494	35568	0		0	35568	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019
7	Qazim Sherif Shurdha			2/347	3196	20	494	9880	0		0	9880	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019
8	Qazim Sherif Shurdha			2/348	3196	40	494	19760	0		0	19760	Vërtetim hipotekor
9	Vadimir Hamit Pelo			2/288	3196	60	494	29640	0		0	29640	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019
10	Mareglen Avdul Hazizi			2/170+1-3	3196	0	494	0	70	30000	2100000	2100000	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019
11	Mareglen Avdul Hazizi			2/170+1-2	3196	0	494	0	37	30000	1110000	1110000	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019; Inskriptohet ne favor te Banka Societe Generale Albania, kontrata nr. 2003 rep , 714 kol, dt 13.5.20136
12	Mareglen Avdul Hazizi			2/170+1-2	3196	0	494	0	8.4		207692	207692	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019
13	Mareglen Avdul Hazizi			2/170-N1	3196	0	494	0	46.7		1319417	1319417	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019; Inskriptohet ne favor te



											Banka Societe Generale Albania, kontrata nr. 3334 rep , 1615 kol, dt 7.12.2016
14	Mareglen Avdul Hazizi	2/170	3196	103	494	50882	0		0	50882	Vërtetim hipotekor
15	Gazmend Dervish Canta Laureta Hysen Canta	2/170+1-1	3196	0	494	0	33	30000	990000	990000	Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019
Vlera Totale Paraprake				1199.5		592553	195		5727109	6319662	

Shënim. 1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000

2. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë truall”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë